




Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës



The Library of Congress, Washington, DC

JAVA E BIBLIOTEKËS NË KOSOVË LIBRARY WEEK IN KOSOVA

Java e Bibliotekës në Kosovë është njëra ndër veprimtaritë më të rëndësishme kulturore ndërkombëtare, e cila organizohet në Kosovë. Këtu e tre vite më parë, themelues të këtij aktiviteti në Prishtinë janë Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës dhe Zyra e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë.

Java e Bibliotekës në Kosovë, si aktivitet i llojit të veçantë, koïncidon me *Javën e Bibliotekës në SHBA*. Pjesëmarrja e ekspertëve amerikanë dhe ndihma e Zyrës Amerikane në Prishtinë, si dhe përfaqësimi i misioneve të tjera ndërkombëtare në Kosovë në këtë aktivitet, dëshmojnë për nxitjen, afirmimin dhe rëndësinë e vlerave kulturore dhe civilizuere.

Roli dhe misioni i bibliotekave kombëtare në shekullin XXI vë në epiqendër, në rrafshin kombëtar e ndërkombëtar, njohjen dhe afirmimin e zhvillimeve më të reja në fushën e bibliotekarisë dhe të informatikës.

Veprimtaria kulturore ndërkombëtare *Java e Bibliotekës në Kosovë* ofron informacione për botën e librit shqip, në njërën anë, si dhe për të arriturat dhe përvojat rezultative të bibliotekarisë më të avancuar në Amerikë dhe Evropë, në anën tjetër.

Viti 2005 për Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës është viti i realizimit të projekteve të rëndësishme, që përcaktojnë ardhmërinë e këtij institucioni, siç janë: sistemi i automatizuar bibliotekar Aleph 500, pastaj hapja e Depoziturës së Bibliotekës së NATO-s, Dhoma e Shkrimtarëve, si dhe fillimi i projektit kapital: Kujtesa e Kosovës.

Library Week in Kosova is one of the most important cultural and international event organized in Kosova. Three years ago this event was first organized by the National and University Library of Kosova and the United States Office in Prishtina.

Library Week in Kosova, as an event of its own kind, coincides with the *National Library Week in USA*. The presence of American experts, the help of United States Office in Prishtina, as well as the participation of other international diplomatic missions in Kosova in this event speak about encouragement, promotion and the importance of cultural and civilized values.

The role and mission of national libraries in the 21 century brings into focus and promotes the latest development in the field of library and information science both in the national and international level.

The international cultural event *Library Week in Kosova*, offers information about the world of Albanian book, on one hand, as well as the latest development in the most advanced library experience of the United States and Europe, on the other hand.

For the National and University Library of Kosova, the year of 2005 is a year of realization of many important projects, which will determine the future of this institution, such as the implementation of Integrated Library System *Aleph 500*, then the establishment of NATO Depository Library, the opening of the Chamber of Writers, and the initiation of the capital project *Kosova Memory*.

600-vjetori i lindjes së Gjergj Kastriotit - Skënderbeut

Viti 2005 është vit jubilar - 600-vjetori i lindjes së Gjergj Kastriotit Skënderbeut, person-alitetit më të shquar të historisë mijërvjeçare shqiptare dhe një ndër figurat historike më të rëndësishme të së kaluarës historike të Ballkanit dhe Evropës. Presidenti i Kosovës - Dr. Ibrahim Rugova vitin 2005 e ka shpallur vit të shënimit të 600 - vjetorit të lindjes së Heroit Kombëtarë të shqiptarëve, Gjergj Kastrioti - Skënderbeu, në mbarë Kosovën. Ky Jubile do të përcillet me manifestime kulturore, shkencore e shtetërore të ndryshme, gjatë të cilave do të kujtohen të bëmat e popullit shqiptar me Gjergj Kastriotin - Skënderbeun në krye, i cili për një çerekshkulli ishte në mbrojtje të truallit të tij dhe të qytetërimit evropian.

Luftërat e Skënderbeut, strategjitë dhe trimëria e tij, bashkëpunimi i tij me Evropën, bënë jehonë të madhe dhe u bënë frymëzim për shumë historianë, shkrimtarë e artistë që këtij heroi të madh t'i kushtojnë me qindra vepra.

Të pakta janë figurat historike, që kanë gjetur një jehonë kaq të gjerë në literaturën botërore gjatë shekujve, siç është figura e heroit Kombëtar shqiptar Gjergj Kastriotit - Skënderbeut. Këtu nuk është fjala vetëm për literaturën e mirëfilltë shkencore, siç është ajo historiografike, por edhe në gjinitë letrare - prozë, poezi, dramë, artet vizuale - pikturë, skulpturë, film etj., që vjen duke u zgjeruar vazhdimisht nga inkunabulat e para të shek. XV dhe deri në ditët tona.

Ndër biografët më të njohurs të Skënderbeut konsiderohet Marin Barleti, humanist shqiptar dhe prift katolik nga Shkodra i shek. XV-XVI, i cili shkroi veprën kapitale "Historia de vita et gestis Scanderbegi, Epirotarum principis", Rome, shtypur nga B.V (Bernardinus de Vitalibus), [1510?, 159 fl.Fo.]. Kjo vepër shërbeu si bazë për shumë biografë të tjerë të Skënderbeut.

Duhet theksuar se numri i njësive bibliografike kushtuar Skënderbeut vazhdimisht rritet, si në krijim të veprave të reja ashtu edhe të zbulimeve të vazhdueshme nëpër vende e biblioteka të ndryshme. Në mbledhjen e shënimeve bibliografike dhe në botimin e tyre një kontribut të madh ka dhënë Biblioteka Kombëtarë e Shqipërisë me botimin e bibliografive: "Albanica" I (shek. XV-XVIII), Tiranë 1965 (e ripunuar dhe e plotësuar më 1998), "Albanica" II (vitet 1800-1849), Tiranë 1987, dhe bibliografia e përgatitur nga Kasem Biçoku dhe Jup Kastrioti: "Gjergj Kastrioti - Skënderbeu, Bibliografi 1454-1835. I", Tiranë 1997.

Gj. BERISHA



Në këtë numër



Për librin shqip dhe sfidat e tij.....3

Në kërkim të periodikut të vjetër6

Tekstet bibliografike në Kosovë

1946-19868

Me sistemin ALCEPH 500 - BKUK po bëhet

burim botëror i informatave.....10

Bibliotekarët dhe profesionit tyre.....13

Organizimi i muzikave në bibliotekë....18

Sfidat e qendrës së restaurimit dhe të

konservimt të BKUK-së.....20



www.biblioteka-ks.org

Botues: BKUK • **Kryeredaktor i botimeve:** Dr. Sali Bashota

Këshilli redaktues: Mr. Shukrie Rama, Bedri Gashi, Fazli Gajraku,
Dr. Bahtie Gërbeshi-Zylfiu, Gjon Berisha

Lektor: Muhamed Çitaku • **Realizimi kompjuterik:** Hekuran Rexhepi

Fotoreporter: Bashkim Binaku

Adresa: Sheshi "Hasan Prishtinë", p.n. Prishtinë

Tel: ++381 38 225-605, **Fax:** ++381 38 248-940 • **e-mail:** biblioteka@biblioteka-ks.org



Dr. SALI BASHOTA

Për librin shqip dhe sfidat e tij

Kumtesën time do ta nis duke parafrazuar një thënie të Stendalit, i cili e këshillonte një fillestar në letërsi që mos t'i lexojë shkrimtarët bashkëkohorë, por t'i lexojë librat që janë shkruar shekuj më herët, në qoftë se dëshiron të shkruajë mirë frëngjisht".

Për jetën kulturore e letrare të Kosovës nuk e di sa vlen një shembull i tillë.

Mendoj, kësaj radhe, se tema për debatim profesional kritik mund të artikulohet në këto nivele: Shkrimtari dhe libri. Libri dhe botuesi. Libri dhe kritika. Libri-biblioteka- lexuesi. Libri dhe tregu. Libri dhe shoqëria.

Këto raporte të ndërvarura dhe jo rrallë në pozicione kundërshtuese, mund të kenë një renditje të gjatë, mbase të pafund të temë-dilemave që shtrohen përbrenda ambientit kulturor të Kosovës.

SHKRIMTARI DHE LIBRI

Temë-dilema e parë ekzistuese është më se e qartë se shkrimtarët, vërtet, gjenden në një pozicion të jo të kënaqshëm, dhe ky pozicion është vështirësuar, sidomos duke filluar nga vitet 90 të shekullit të kaluar, kur nga regjimi serb u bë rrënim i institucioneve kulturore, arsimore, shkencore të Kosovës. Kjo është

pjesa e hidhur dhe e dhembshme e realitetit të kaluar, që ndërlidhet, gjithsesi, edhe me djegien e bibliotekave, librave, dorëshkrimeve, madje edhe me vrasjen e shkrimtarëve dhe personaliteteve të kulturës.

Pozicioni i shkrimtarit, fatkeqësisht, edhe pas luftës në rrethana të reja të lirisë dhe demokracisë, nuk ka ndryshuar, sa i përket përmirësimit të statusit të tij në shoqëri. Në Kosovë asnjë shkrimtar nuk jeton nga vepra e vet, domethënë nga vepra që shkruhet, botohet dhe shitet. Idealiteti i deridjeshëm i shkrimtarit për një pozicion më të mirë dhe më të favorshëm në shoqëri shfaqet bashkë me paradoksin e mirëkuptimit, në një mjedis ku kujdesi për punën dhe kontributin e shkrimtarit është minimal: nuk stimulohet mbase, jo rrallë, është edhe i shpërfillshëm.

Bëhet pyetja: kush e mbron të drejtën e shkrimtarit? Sa funksionon ligji në Kosovë për mbrojtjen e autorëve? Sa mbështeten projektet e shkrimtarëve, të cilët prodhojnë vlera letrare e kulturore për popullin e vet? Mund të bëhen një varg i gjatë pyetjesh ku paradokset e ndjekin njëri-tjetrin dhe nuk e di a do të kenë përgjigje të qartë, të vërtetë dhe të drejtë.

LIBRI DHE BOTUESI

Në Kosovë para luftës ka funksionuar një shtëpi e vetme botuese me traditë të gjatë, siç është "Rilindja", institucion i vetëm

botues i mbështetur nga buxheti i Kosovës, që ka dhënë një kontribut të madh në botimin dhe afirmimin e vlerave letrare, qoftë të autorëve të traditës, qoftë të autorëve bashkëkohorë. Fama e deridjeshme e këtij botuesi sot po zbehet gjithnjë e më tepër, edhe pse e ka statusin e botuesit gjysmëqeveritar. Në këtë periudhë kanë funksionuar edhe dy botues tjerë privat "Buzuku" dhe "Dukagjini", të cilët e kanë dhënë ndihmesë në fushën e botimeve, duke e profilizuar veprimtarinë e tyre.

Si është çështja sot me botuesit e Kosovës? Përgjigja është e qartë: nuk janë në pozicion të lakmueshëm. Vetëm në disa raste të veçanta përkrahen projektet e tyre. Faktikisht, nuk mund ta zhvillojnë veprimtarinë e tyre të rregullt në mungesë të përkrahjes shoqërore, edhe kur është fjala për botimin e veprave apo për ndonjë aktivitet tjetër kulturor. Dihet saktë: në Kosovë sot librin e sponsoren vetë autori apo botuesi privat.

Në anën tjetër, organizimi i panaireve të librit ka qenë rezultativ. Gjithsesi, panairët e librit të organizuara në nivelin kombëtar kanë treguar një formë të mirë të përhapjes së librit tek shtresat e lexuesve, natyrisht të komunikimit edhe me librat e mirë. Këto ide dobiprurëse do të ndikojnë në qarkullimin e vlerave brenda letërsisë shqipe në njërin anë, por edhe në ekspozimin e këtyre vlerave në panairë ndërkombëtare, ku do të duhej të

/ vijon në faqe 4 /



kishim sa më shumë botime të përkthyer në gjuhë të mëdha të botës për të prezantuar letërsinë dhe kulturën tonë.

LIBRI DHE KRITIKA

Në atmosferën tonë kulturore dhe letrare ekziston fenomeni i favorizimit të jovlerave, kiçit, shundit etj., veçanërisht në mediumet elektronike, por ka raste edhe në mediumet e shkruara. Jovlera servohet si vlerë dhe lexuesi i painformuar ushqehet një kohë të gjatë me shijet negative, të cilat janë e dëmshme për të ardhmen e tij. Në botë dihen raste jo të rralla, që librat të botohen në sasi prej 30-50 ekzemplarëve dhe t'u shpërndahen vetëm miqve të ngushtë. Domethënë, ai konsiderohet si libër që nuk mund të plasohet në mediumet elektronike dhe të shkruara, sepse shkruesi i tij në mënyrë të vetëdijshme pajtohet me jovlerat e veta.

Tek ne, fatkeqësisht është krejtësisht ndryshe.

Problemi i vlerësimit të produktionit botues sot në Kosovë është një ndër problemet më të ndjeshme në jetën tonë letrare. Pos kriterit të

botimit dhe potencialit ekzistues të vlerave që ofrohen, vlerësimi kritik publik i rezultateve, mangësive dhe dështimeve në nivelin profesional, p o t h u a j s e , mungon. Doemos, përballë propagandimit të librit, kritika letrare gjendet në situatë të pamundshme që të përcjellë në mënyrë të rregullt librin duke e dhënë fjalën meritore për të.

Asnjë gazetë as revistë letrare në Kosovë nuk e ka, fjala vjen, këndin e caktuar të vlerësimit profesional kritik: për poezinë e dobët, për prozën e dobët, për dramën e dobët, për kritikën e dobët. Domethënë: për veprën e dobët. Këso mënyre, ende mungon guximi kritik , intelektual dhe qytetar për të definuar qartë edhe pozicionin e shkrimtarëve, edhe pozicionin e shkruesve. Vërtet, a ekziston kriza e vlerësimit kritik? A ka më shumë shkrues se sa shkrimtarë?

Kompania mediale "Koha ditore", duke ia ofruar lexuesit të Kosovës librat më të mirë të shkrimtarëve botërorë dhe shqiptarë të shekullit XX, bën një gjest të shkëlqyeshëm kulturor, por fatkeqësisht në këtë zgjedhje i përjashton autorët më të njohur të Kosovës. Fjala vjen, në këtë konkurrencë lirisht do të mund të hynte romani "Oh" i Anton Pashkut.

Në të gjitha variantet e këtij pikëshikimi, vetëm institucionet shtetërore me njerëz të ditur, kompetentë e profesionalë mund të shprijnë përpara edhe mendimin kritik. Para disa vitesh në Kosovë është

provuar një debat shumë i suksesshëm midis shkrimtarëve, kritikëve dhe lexuesve, kuptohet për procesin krijues, por edhe për ndërtimin e kriterëve vlerësues, si dhe për promovimin e vlerave letrare, por nuk ka vazhduar më tutje për shkak të mospërkrahjes institucionale dhe mungesës së fondeve.

LIBRI - BIBLIOTEKA - LEXUESI

A e ka Kosova lexuesin e vet edhe në kohën e teknologjisë dhe të komunikimit modern me librin përmes internetit dhe katalogëve elektronikë. A duhet kërkuar ende forma dhe mënyra për të rikthyer lexuesin tek libri, kuptohet edhe për rikthimin e dinjitetit të letërsisë. Përbrenda kësaj problematike i shoh dy rrugë:

Problemi i parë: sa është i pranishëm libri në shtëpitë tona, në bibliotekat e shkollave, fakulteteve, në bibliotekat publike etj.

Problemi i dytë: a shpjegohen ende në shumicën e institucioneve të arsimit të ulët, të mesëm e universitar veprat letrare sipas metodave të vjetra, ku biografizmi, historicizmi, pozitivizmi janë alga e omega e ligjëritimit. Pra, metoda, kriteri, përzgjedhja e autorëve dëftojnë edhe për mënyrën e leximit, mësim-it, shpjegimit, interpretimit dhe kuptimit të letërsisë.

Në rastin e parë, të gjitha statistikatat mund të dëshmojnë se libri i botuar në Kosovë nuk shpërndahet në të gjitha bibliotekat e Kosovës. Problemi ekziston tek rrjeti i organizimit, forma e shpërndarjes dhe mungesa e fondeve për blerje. Derisa botuesit detyrohen sipas ligjit të dorëzojnë në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës ekzemplarin e detyrueshëm, bibliotekat publike duhet ta kenë të qartë se

pasurimi me botimeve të reja është detyrë dhe obligim shoqëror.

Sipas standardeve ndërkombëtare 1.5-2.5 libra duhet të jenë për kokë banori. Sa i plotëson Kosova këto kritere?

Sipas të dhënave më të reja në Kosovë funksionojnë gjithsej 468 biblioteka. Këtu hynë edhe Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, pastaj bibliotekat publike, të fakulteteve, shkollore dhe speciale. Në të gjitha këto biblioteka fondi i librave është mbi 3 milionë ekzemplarë, aq sa ka përafërsisht një bibliotekë publike në një qytet të madh evropian.

LIBRI DHE TREGU

Northrop Fraji ka thënë: "Letërsia është njohur gjithmonë si prodhim tregu, prodhuesit e së cilës janë shkrimtarët krijues, kurse konsumuesit lexuesit e kulturuar, me kritikët në krye."

Në Kosovë paradokset dhe hutia mund të lëvizin në kahe të ndryshme, sa i përket çështjes së librit. Fenomenet mund të kenë edhe përmasa të tjera sa që mbase më shpesh mund të flitet për akulturimin se sa për kulturimin.

Ky është një dimension tjetër që mund të shtrohet në variacionet e veta përbrenda këtij shkrimi.

Libri i botuar në Shqipëri, kuptohet i doganuar hyn me vështirësi në Kosovë. Tatimet doganore për librin ende janë në fuqi. Tregu i Kosovës mbulohet tërësisht me librin e importuar nga Shqipëria, por tregu i Shqipërisë, pothuajse, nuk mbulohet fare ose pak me librin e botuar në Kosovë. Rrjedhimisht, duhet të krijohen mekanizmat institucionale që do të ndërmerrin veprime konkrete lidhur me shpërndarjen, qarkullimin dhe

përhapjen e librit. Assesi monopoli i një hapësire nuk mund ta ngufasë hapësirën tjetër.

LIBRI DHE SHOQËRIA

Pas të gjitha këtyre shqyrtimeve dhe analizave të iniciuara përmes ideve në relacionet e përmendura: shkrimtari dhe libri; libri dhe botuesi; libri dhe kritika; libri- biblioteka- lexuesi; libri dhe tregu, pa i zgatur më tutje këto relacione, vetvetiu mbërrijmë dashur e padashur tek raporti i librit me shoqërinë.

Nga të gjitha variantet e pikëshikimit të kësaj problematike, në esencë, duhet krijuar një strategji

shoqërisë së Kosovës a po e përjeton kultura krizën e vet, në këtë kontekst edhe libri?

Prapë temë dilemat mund të përsëritet në variante dhe versione të ndryshme. A kemi ende shifra sa libra janë për kokë të banorit në Kosovë? Në vitet tetëdhjeta të shekullit të kaluar në Kosovë mesatarisht janë botuar 350 tituj të rinj vetëm nga një shtëpi botuese, kuptohet letërsi shqipe dhe letërsi e përkthyer. Si është gjendja sot, kur botuesit privatë kanë vullnet dhe kur institucionet që do të duhej të mbështesnin politikën kulturore, në një mënyrë nuk e ofrojnë gatishmërinë e tyre.

Fundja, thelbi i kësaj problematike që ka të bëjë me librin dhe krizën e tij, prapë



të re kulturore për librin. Shkrimtarët, botuesit bashkë me institucionet që do të duhej të financonin librin duhet t'i hartojnë projektet e tyre të qarta në botimin e vlerave letrare. Po ku shkojnë këto projekte? Po kush i jetëson këto projekte? Pa përkrahjen, nxitjen, stimulimin, afirmimin e vlerave kulturore nuk mund të njihen as për së afërmi vlerat fundamentale të identitetit të një populli.

Në këtë fazë të demokratizimit të

rikthehet në sfondin e vet, ku buron e rrjedh vetë funksioni i letërsisë përbrenda trekëndëshit: autori-libri-lexuesi.

Kështu ndërlidhen procesi krijues, procesi botues dhe procesi komunikues.

Dhe sfidat për dhe me librin shqip ende vazhdojnë në hapësirën tonë kulturore...

(Fjalë hyrëse në Tribunën Kriza e librit, Prishtinë, 23 shkurt 2005 organizuar nga PEN Qendra e Kosovës)



Në kërkim të periodikut të vjetër

(1848-1912)

(I)

GJON BERISHA

Botimet e para të periodikut filluan jashtë atdheut. Në kushtet e sundimit të egër të pushtuesve turq, mësimi dhe shkrimi shqip ishin të ndaluar. Propagandimi i hapur i ideve të lëvizjes kombëtare çlirimtare ndëshkohej rëndë nga Porta e Lartë. Botimi i një organi shqip në trojet shqiptare, ishte jo vetëm i rrezikshëm, por edhe i pamundshëm.

Detyrën e nxjerrjes së botimeve periodike e udhëhoqën kolonitë shqiptare në mërgim. Ato filluan aktivitetin e botimeve të gazetave dhe të revistat të para në gjuhën shqipe e në gjuhë të huaja.

Shtypi shqiptar i hodhi hapat e parë me gazetën "L'Albanese d'Italia" - "Shqiptari i Italisë", e botuar në Napoli, më 1848, nga figura e njohur e letërsisë së Rilindjes Kombëtare Shqiptare, Jeronim de Rada. Gazeta botohej dy herë në javë në gjuhën italiane dhe pjesërisht në shqip (arbërisht). Numri i parë doli më 23 shkurt 1848, ndërsa i fundit më 3 qershor 1848.

Gazeta përmbante informacione politike, morale dhe letrare. "L'Albanese d'Italia" dilte dy herë në javë - çdo të mërkurë dhe të shtunë, me një format të vogël, katërfaqësh, dhe u botuan 27 numra të saj. Gazeta njihet si e para gazetë në historinë e shtypit shqiptar të Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

Më 1860, në Lamia të Greqisë, fil-

loi botimi e gazetës "Περσική Τη" - "Pellazgu", si e përjavshme politike dhe shoqërore. Drejtues i saj ishte Anastas I. Byku - "Piqueu". Ajo botohej në gjuhën greke dhe pjesërisht në gjuhën shqipe me alfabet grek. Më vonë gazeta mori emrin "Pellazgoitis" dhe mbante nëntitullin shqip "Shqiptari dhe greku". Numri i parë doli më 1 janar 1860 dhe vazhdoi punën gjatë një viti.

Në Kosovë, disa vjet më vonë, filluan të dalin dy gazeta: "Prizren" dhe "Kosova". Gazeta "Prizren", botohej në Prizren në shtypshkronjën e Vilajetit dhe ishte e përjavshme në gjuhën turke dhe serbe. Numri parë doli më 15 gusht 1871 dhe vazhdoi deri më 1874. Gazeta tjetër "Kosova", ishte Organ Zyrtar i Vilajetit (1877-1888), që doli një herë në javë në gjuhën turke. U botua në shtypshkronjën e Vilajetit në Prishtinë dhe dolën gjithsej 550 numra.

Pas 31 vjetësh (nga gazeta e parë shqiptare "L'Albanese d'Italia") më 24 qershor 1879, në Shkodër botohet e para gazetë në gjuhën shqipe në territoret shqiptare. Kjo ishte gazeta "Ishkodra". "Ishkodra", Organ i Vilajetit të Shkodrës, botohej një herë në javë - çdo të enjte në gjuhën shqipe me alfabet arab dhe turke. Që në vitin 1880, u bë Organ i Degës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në Shkodër. Në 24 vjetët e botimit, "Ishkodra" ishte me frymë thellësisht kombëtare shqiptare.

Në vitin 1979, në Athinë, boto-

het edhe një tjetër gazetë e përjavshme shqiptare në gjuhën greke dhe pjesërisht në gjuhën shqipe me alfabet grek, prej katërfaqësh, me titull "Περσική Τη Albanian" - "Zëri i Shqipërisë", nga arbëreshi Anastas Kullarioti. Gjatë viteve 1879-1880 dolën 40 numra.



Organet e para shqipe që i dhanë frymë publicistikës së asaj kohe ishin edhe "Fiamuri Arbërit" dhe "Drita-Dituria".

Revista "Fiamuri Arbërit", numri i parë i së cilës doli nga shtypi më 20 korrik 1883, pasqyronte ngjarjet e luftës çlirimtare të popullit shqiptar. Ajo u botua fillimisht në Kariliano-Kalabro deri më 20 gusht 1885, ndërsa në Kozenca nga 20 shtatori 1885-15 nëntor 1887. Botohej në tetë faqe, në shqip dhe italisht dhe përbëhej prej dy shtyllave.

Në periodikun e kohës u shfaq me sukses edhe revista "Drita-Dituria". Më 10 gusht 1884 Shoqëria e Stambollit boton revistën "Drita", e përnuajshme kulturore, letrare e arsimore. Numri i parë u botua nën përkujdesjen e Petro V. Pogës, kurse numrat e tjerë nga Pandeli Sotiri dhe vëllezërit Frashëri, Samiu dhe Naimi.

Revista doli në gjuhën shqipe me alfabet të hartuar nga Shoqëria e Stambollit. Ndërsa, revista **“Dituria”**, që zëvendësoi revistën **“Drita”**, u botua gjatë viteve 1884-1885. Një revistë tjetër e botuar prej arbëreshëve të Italisë, është edhe **“La Giovane Albania”-“Arbri i Rif”**. Revista ishte e përmuajshme dhe dilte në gjuhën shqipe me alfabet arab dhe në gjuhën italiane. Numri i parë doli më 31 mars 1887 nën përkujdesjen e Françesko Stasit dhe Zef Skiroit.

Më 15 maj 1887, në Braila të Rumanisë, doli numri i parë i javores **“Drita”**, me karakter letrar-shken-cor. Numri 3 i saj u quajt **“Lumina”-“Drita”**.

Më 7 gusht 1888, Nikolla Naço boton gazetën **“Sqipetari”** në Bukuresht të Rumanisë. Kjo gazetë ishte e përjavshme politike, shoqërore, kulturore dhe letrare. Botohej në gjuhët: shqip, rumanisht, frëngjisht dhe kishte 4 faqe. Ajo u botua deri më 1903. Si Organ i Shoqërisë **“Drita”** të Bukureshtit, angazhohej për përhapjen e arsimit dhe të ditorisë.

Edhe pse doli me ndërprerje (1888-1889), pastaj më 1899 e më pas më 1903, **“Sqipetari”** arriti të njihet si organ që ndihmoi për njohjen e së kaluarës historike të popullit shqiptar.

Qëkur **“Ishkodra”** do t'i mbushte 2 vjet, në mars të vitit 1891, në Shkodër doli gazeta e parë vetëm në gjuhën shqipe - **“Elcija i Zemres t'Jezu Kriscit”**, e përkohshme, mujore dhe fetare e klerit katolik.

Ndonëse, u botua për 22 vjet si organ i Kolegjit Jezuit, **“Elcija i Zemres t'Jezu Kriscit”**, jo vetëm që ishte gazeta, më vonë revista, më jetëgjatë e botuar ndonjëherë nga shqiptarët, që përfshin vitet 1891-1944, por edhe mori primatin e një tribune të shqiptarizmsë. Përveç drejtorit të kësaj reviste, Pater Jak Jungu,

në të kontribuuan personalitete të shquara katolike dhe jokatolike të Shkodrës dhe të Shqipërisë.

Në vitin 1914, revista ndërron emrin në **“Lajmtari i Zemres t'Jezu Kriscitit”**. Deri në vitin 1909, revista u botua në gjuhën shqipe me alfabetin e autorëve të vjetër të Veriut dhe me alfabetin italian, ndërsa më vonë u botua me alfabetin e aprovuar në Kongresin e Manastirit-variantin latin. Në vitin 1908 filloi të botohet edhe një shtesë me titull: **“Pjesa e II kulturele e letrare”**.

Në vitin 1894 filloi të botohet edhe revista **“Iskodranin Vilayet Salnamnesi-dir”-“Vjetari i Vilajetit të Shkodrës”**. Kjo revistë botohej në gjuhën turke dhe përmban kalendarin e vitit dhe njoftime zyrtare të administratës së vilajetit të Shkodrës.

Përgjatë periudhës 16 korrik 1895 - 1 janar 1896, në Bukuresht doli gazeta letrare dhe edukative me titull **“Çqimetari” - “Albanezul”**, nën përkujdesjen e Aleks Çikozit dhe profesor Pedreskut. Gazeta doli gjithsej në tetë numra dhe u botua në dy gjuhë - shqipe dhe rumune.

Botimet periodike të arbëreshëve të Italisë, më 1 gusht 1896, u pasuruan edhe me revistën e përmuajshme kulturore, shoqërore, letrare, folklorike dhe gjuhësore, me emrin **“Ili i Arbresvet” - “La Stella degli Albanesi”**. Pas Kongresit të Dytë **“Ili i Arbëreshëve”** u zëvendësua nga gazeta **“La Nazione Albanese” - “Kombi Shqiptar”**, si buletin politik, letrar e kulturor, nën përkujdesjen e Alsemo Lorecchios. Numri i parë i këtij buletini doli në Pallagorio më 15 janar 1897. Botohej dy herë në muaj në gjuhën italiane dhe në gjuhën shqipe.

Një revistë tjetër e përdyjavshme filloi të dalë në Corigliano Calabro me emrin **“L'Albania Letteraria” - “Shqipëria Letrare”**. Numri i parë doli më 10 shkurt 1897.

Nga shqiptarët e Malësisë së Mbishkodrës, të cilët braktisën vendin e tyre dhe u vendosën në paralajmërinë e Zarës të quajtur **“Borgo Erizzo”**, në vitin 1897 filluan orvatjet për botimin e gazetës **“Zani i Shqiptarit”**. Edhe përkundër pohimeve të Palok Dakës se janë botuar vetëm pak numra në vitin 1897 (shih. *P.Daka, Bibliografi retrospektive e shtypit periodik shqiptar e mbi Shqipërinë e viteve 1848-1944, në Studime Historike, 3 Tiranë 1971*), deri sot nuk është gjetur ndonjë numër i kësaj gazete, por është gjetur vetëm proklamata e kësaj gazete në Arkivin Historik të Zarës (*M. Tërnavë, Çështja e botimit të gazetës “Zani i Shqiptarit”, në Gjurmime Albanologjike - seria historike, 3/1973, Prishtinë 1975*).

Në vitin 1897 me iniciativën e Faik Konicës, me pseudonimin Tk. Spirobeg, filloi të botohet revista në gjuhën shqipe **“Albania”**. Kjo revistë u themelua në vitin 1896, por numri i parë doli më 25 mars 1897. Prej vitit 1897 deri më 1901 u botua në Bruksel, kurse prej vitit 1902 në Londër.



Veprimtarët e Kolonisë Shqiptare të Rumanisë filluan botimin e të përjavshmes **“Shqipëria”**, në vitin 1897. Visar Dodani përkujdesej që ajo të dilte në gjuhën shqipe, rumune, frënge dhe greke. Kjo gazetë ruhet e plotë edhe në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës.

/ vijon në numrin e ardhshëm/

Tekstet bibliografike në Kosovë 1946-1986

Mr. TAHIR FONIQI

Me termin Bibliografi në Kosovë, për herë të parë, ndeshemi më 1946. Që nga ky vit e në vazhdim revista shkencore Përparimi, nën titujt: Bibliografi, Libra në gjuhën shqipe dhe Libra të reja, prezanton librat e botuara në Kosovë gjatë periudhës 1948-1958, me qëllim të ruajtjes së trashëgimisë sonë kulturore, letrare e kombëtare. Ngjashëm me këtë revistë veprojnë edhe gazeta Rilindja, revista letrare Jeta e re e ndonjë tjetër.

Që nga viti 1946 deri më 1986 në Kosovë janë botuar rreth 300 tekste bibliografike, të cilat i kemi ndarë në tri grupe:

- Tekstet bibliografike në dorëshkrim (në formë të artikullit e të librit);
- Tekstet bibliografike të botuara në formë të artikullit;
- Tekstet bibliografike të botuara në formë të librit.

Tekstet bibliografike në formë të artikullit, rëndom, prezantohen si shtojca të magjistraturave, të doktoraturave e të formave të tjera të ngjashme. Kështu, në Qendrën për Informata Shkencore dhe Veprimtari Referale të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës në Prishtinë kanë qenë 80 tekste bibliografike, të hyra në këtë Bibliotekë deri më 1986: të Sabri Hamitit, Resmije Kryeziut, Fadil Rakës, Muhamet Kërveshit, Vedat Kiserit etj.

LLOJET E BIBLIOGRAFIVE

Gjatë periudhës 1946-1986 janë botuar rreth 20 lloje të teksteve bibliografike, të tri grupeve të përmendura, prej të cilave kanë dominuar: bibliografia me bazë në autor, bibliografia elementare, bibliografia kronologjike, bibliografia analitike, bibliografia anotuese, bibliografia indikative, bibliografia primare etj.

- Bibliografia me bazë në autor (Sefedin Fetiu, Agim Deva, Palok Daka, Ymer

Jaka, Isak Shema, Ibrahim Rugova);

- Bibliografia kronologjike (Mensur Raifi, Tahir Foniqi, Veli Veliu, Ali Rexha, Engjëll Sedaj, Floresha Dado, Ibrahim Goçi, Ramiz Kelmendi, Sevdie Ahmeti, Mehmet Gërguri, Musa Gërguri, Milazim Krasniqi, Abdyl Ramaj, Emine Fetahu, Jonuz Fetahaj);
- Bibliografia elementare (Agim Vinca, Ibrahim Rugova, Mesur Raifi, Rexhep Qosja, Sabri Hamiti, Sevdie Ahmeti, Shkëlzen Raça, Anton Berisha, Ymer Jaka, Fadil Raka, Muhamet Kërveshi, Resmije Kryeziu, Emine Fetahu, Jonuz Fetahaj, Enver Baki, Vedat Kiseri, Agim Deva);
- Bibliografia analitike (Drita Halimi-Statovci, Kadri Halimi, Mehmet Gjevori, Sulejman Drini, Adem Demaçi, Ali Rexha, Tatomir P. Vukanoviq);
- Bibliografia anotuese (Rexhep Ismajli, Tatomir P. Vukanoviq, Palok Daka, Ramiz Kelmendi, Nahire Kabashi, Vladimir Bovan, Vladimir Cvetanoviq, Zoran Pavloviq, Dragolub Petroviq, Zymber Hasan Baku (Kruja);
- Bibliografia indikative (Enver Baki, Jup Kastrati, Emine Fetahu, Bujar Shehu);
- Bibliografia sipas rregullave të KUD-it (Sevdie Ahmeti);
- Bibliografia rekomanduese (Qazim R. Lleshi);
- Bibliografia primare (Sevdie Ahmeti, Tahir Foniqi, Veli Veliu);
- Bibliografia e përgjithshme (Tatomir P. Vukanoviq, Vladimir Bovan, Dragolub Moraçiq, Zoran Pavloviq) etj.

MANGËSITË E TEKSTEVE BIBLIOGRAFIKE

Pjesa më e madhe e teksteve bibliografike është hartuar me bazë në autor, përkatësisht me bazë alfabetike globale ose germë për germë. Por, ka edhe tekste, që janë mbështe-



tur vetëm në alfabetizimin elementar, do të thotë të shkronja e parë e fjalës.

Mbështetur në tekstet bibliografike në shqyrtim (1946-1986), shumica të hartuara nga punonjësit joprofesionalë, konstatohet lehtë se ato kanë mangësi të shumta e gjithfarëshe, krahasuar sidomos me standardet ndërkombëtare anglo-amerikane. Është dukuri e përgjithshme se hartuesit kanë qenë të orientuar kryesisht kah shkencat shoqërore: letërsia, gjuhësia, historia, folklori, letërsia gojore, etnologjia etj. Ndërsa, janë lënë pasdore shkencat natyrore dhe ekzakte. Ne e kemi hasur vetëm një tekst bibliografik nga shkencat natyrore, atë të Qazim R. Lleshit.

- Ndonjë hartues nuk i përdor drejt pseudonimet në funksion të përcaktueses (Ymer Jaka),
- Thuajse të gjithë hartuesit e teksteve bibliografike e bëjnë përsëritjen e përcaktueses. Po e zëmë Jusuf Buxhovi, në kapitullin Letërsia e sotme te librit Bibliografi e kritikës letrare shqiptare '44-'74, është përdorur 120 herë, Ali Aliu 96, Mensur Raifi 73, Dilaver Dilaveri 33 etj.
- Ndonjë hartues ka përdorur ndonjë formë tashmë konvencionale të hartimit të bibliografive (Milazim Krasniqi),
- Disa hartues i kanë hyrë kësaj veprimtarie intelektuale pa njohje të mirë të lëndës në shqyrtim, përkatësisht pa njohje solide të letërsisë, historisë së letërsisë, teorisë së letërsisë etj. (Sevdie Ahmeti, Amedan Jani, Musa Gërguri). Kështu në Jeta e re Bibliografia 1949-1974, shkrimtarët Hysein Bashiq, Rade Nedelkoviç-Dika dhe poetesha rumune Florika Shtefan janë trajtuar shkrimtarë shqiptarë. Në anën tjetër, shkrimtarët jugosllavë janë marrë rusët: Aleksandar Bllok, Boris Pasternak e Isak Babel. Ndërsa shkrimtarë botërorë janë trajtuar edhe slloveni Franc Bevk e malazias Mark Milani.
- Disa bibliografë nuk e kanë vjelë edhe artin pamor në tekstet e tyre bibliografike: fotografitë artistike, skicat, vinjetat, gravurat, pikturat, vizatimet etj.

(Sevdie Ahmeti, Musa Gërguri, Amedan Jani, Emine Fetahu). Kështu, vetëm në gjashtë numra të revistës Jeta e re të vitit 1959, janë botuar 66 njësi të arteve pamore të Selatin Ahmetit, Demir Behlulit, Tahir Emrës, M. Nurës, Sulejman Kadrisë, P. Emrës, Nebih Muriqit, Nebih Emrës, Bedri Emrës, Rexhep Ferrit, Miomir Zubiçit, F. Thaçit, S. Hoxhës etj; apo në numrin 2/1972 të revistës Gjurmime Albanologjike gjenden 37 njësi bibliografike: fotografi, skica e gravura.

- Disa hartues e kanë bërë vetëm ndarjen elementare alfabetike të njësisive bibliografike;
- Disa hartues nuk e kanë bërë as ndarjen alfabetike elementare (Vladimir Bovan, Vladimir Cvetanoviç, Zoran Pavloviç, Dragolub Petroviç);
- Disa hartues nuk e bëjnë ndarjen alfabetike edhe të njësisive bibliografike brenda tekstit bibliografik, por ndalen vetëm te autorët (Ali Rexha, Abdyl Ramaj, Milazim Krasniqi);
- Disa hartues nuk i pasurojnë tekstet e tyre bibliografike me tregues (Ali Rexha, Milazim Krasniqi, Qazim R. Lleshi);
- Disa hartues nuk i përdorin drejt përcaktueset e njësisive bibliografike (Ali Rexha, Milazim Krasniqi);
- Te disa tekste bibliografike, ndonëse mëtojnë që të jenë të plota, mungojnë tituj librash apo njësisish bibliografike (Agim Deva). Kështu, në studimin Poezia shqipe për fëmijë (1872-1980) të Agim Devës, mungon libri i Jetish Kadishanit Ecnii ballëhapur, Prishtinë, 1974; ose te libri i Agim Vincës Struktura e zhvillimit të poezisë së sotme shqipe (1945-1980), Prishtinë, 1985, f. 493 (treguesi i emrave) mungon emri i autorit Nexhmedin Soba.

PËRFUNDIMI

Më së shumti tekste bibliografike, gjatë periudhës 1946-1986, kanë hartuar Tahir Foniçi, mbi 20, Mensur Raifi e Tatomir P. Vukanoviç nga 7, Sevdie Ahmeti 5, Emine Fetahu 3 etj.

Hartimi i bibliografisë nuk është punë e lehtë. Bibliografia përballet me sfida politike, profesionale, të saktësisë etj. Në anën tjetër, bibliografia kërkon punë titanike, durim e angazhim të përhershëm dhe njohje të gjerë të rregullave ndërkombëtare të hartimit të bibliografisë, aq më tepër kur dihet se ky lloj i literaturës doracak nuk e ka mundësinë e ribotimit të shpeshtë, sikurse e kanë beletristika, tekstet shkollorë etj. Bibliografi, njëherësh, duhet të ketë njohuri solide për të gjitha disiplinat shkencore e dijet 0/9. Në mënyrë të veçantë ai duhet ta njohë kulturën e shkrimit, letërsinë (kombëtare e ndërkombëtare), historinë e letërsisë, kritikën letrare etj.



Unë e mbroj mendimin se bibliografia ia kalon edhe enciklopedisë, ngase hartohet "de visu" (drejtpërdrejt nga burimi), gjë që nuk ndodh kurdoherë me enciklopeditë.

(Kumtesë e lexuar në BKUK të Kosovës, më 29 tetor 2004)

INTERVISTË EKSKLUZIVE ME PETE SUDELL-in, MENAXHER NË KOLEGJIN MBRETËROR TË LONDRËS I SISTEMIT TË AUTOMATIZUAR BIBLIOTEKAR ALEPH 500

Me sistemin **ALEPH 500** - BKUK po bëhet burim botëror i informatave

Një ambient i lashtë mbretëror në Londër. Një arkitekturë e veçantë dhe unikate, që daton prej vitit 1829. Kështu mund të përshkruhet objekti i Kolegjit Mbretëror të Londrës. Në këtë kolegji funksionon biblioteka moderne, e cila punon me sistemin e automatizuar bibliotekar ALEPH 500, menaxher i të cilit është Pete Sudell, me përvojë profesionale 30-vjeçare. Kur takohesh me Pete Sudell-in, të formohet menjëherë përshtypja se ke të bësh me një njeri të sprovuar në fushën e bibliotekarisë. Para tij ndjehesh rehat si para një njeriu që jep këshilla dhe përgjigje për zhvillimet më të reja të sistemit informativ dhe për perspektivat e tij. Ai flet për veprat konkrete, për rezultatet e arritura dhe për sfidat me të cilat ballafaqohet çdo bibliotekë e kohëve tona.



>>> *PETE SUDELL-in, menaxher në Kolegjin Mbretëror të Londrës i Sistemit të Automatizuar Bibliotekar ALEPH 500*

Z. Sudell, që të flasim për të arriturat e suksesshme të punës suaj, duhet të kthehemi në retrospektivë. A mund të na revokosh përvojën tuaj të sintetizuar tridhjetëvjeçare?

P. SUDELL: Fillimet ishin jashtëzakonisht interesante për mua. Kur u punësova në bibliotekë, mësova të katalogoj materialet bibliotekare. Kjo punë më nxiti ta kuptoj rëndësinë e indeksimit dhe numrit të kontrollit. Pastaj, u angazhova edhe në pasurim, fushë kjo që më bëri të kuptoj domosdoshmërinë e gjetjes së informacioneve të sakta për t'ua mundësuar librashitësve ofrimin e materialeve, që i kërkonim. Gjetëm zgjidhje, por me disa gabime të vogla. Kjo ishte një periudhë kur ende nuk ekzistonte qasja në faqet elektronike (WEB). Pas kësaj

periudhe, biblioteka, në të cilën punoja, u bë iniciatorja e parë, për futjen e një sistemi të automatizuar në Universitetin e Londrës. Unë u inkuadrova në këtë proces krejt rastësisht, si vullnetar. Përfshirja ime në këtë proces, më ndihmoi që çdo ditë e më tepër të bëhesha më i afërt me informacionet dhe risitë e ndryshme të shërbimeve, të cilat mund t'i ofrojnë sistemi i parë në Kolegjin Mbretëror.

SFIDAT E AUTOMATIZIMIT

Në këtë kontekst, konstatoj se biblioteka juaj ka kaluar nëpër sfida të ndryshme. Nëse pajtoheni me këtë konstatim, në cilat faza u shfaqën ato më së tepërmi?

P. SUDELL: Gjatë procesit të automa-

tizimit, në të gjitha bibliotekat me të cilat synonim të kishim një bazë dhe të përdornim një sistem të përbashkët, sfidat e para rezultuan gjatë harmonizimit të materialit dhe të të dhënave të katalogut. Tërë këtë punë e bëmë dhe arritëm deri te rezultatet e sotme: kemi gjysmë milioni njësi bibliografike të librit, pa e përfshirë këtu periodikun, ndërsa materiale të rralla mbi 115.000 libra, të cilat datojnë nga viti 1483.

Aktualisht, rrjeti ynë menaxhon 4 milionë dokumente origjinale, përfshirë të dhënat e shkruara nga mbretëritë dhe institucionet e tjera viktoriane.

Si sfidë tjetër për ne ishte edhe lëvizja e librave nga një ndërtesë në tjetrën, si dhe harmonizimi i materialeve të të gjitha bibliotekave, në mënyrë që të krijoheshin shërbime më cilësore. Faktikisht, kjo punë na ka marrë shumë kohë. Edhe aspekti financiar na trazonte shpesh, sepse atëbotë buxheti për blerje të librave dhe gazetave ishte i kufizuar.

Në fillim përdornim sistemin e automatizuar vetëm për qëllime të qarkullimit. Mirëpo, shpejt e kuptuam se ishim të gatshëm të ofrojmë qasje shumë të kufizuar të OPAC. Kjo ka ndodhur në vitin 1980. Gjithashtu, kuptuam se kishim nevojë për mbajtjen e statistikave për përdoruesit e materialeve. Për fat të mirë, e vërejtëm se edhe Sistemi i Sigurisë së Librit ishte shumë i nevojshëm për bibliotekë. Tash kemi në dispozicion edhe sistemet automatike vetëshërbyese të përdoruesve dhe sistemet automatike të kthimit të materialit.

A mundet një bibliotekë të zgjedhë rrugët e shkurtra dhe të lehta në procesin e automatizimit?

P. SUDELL: Kurrë mos u ngutni! Ndoshta ekzistojnë disa mënyra për aktivizimin e sistemeve të automatizuara, por ekziston vetëm një mënyrë për përdorimin e të dhënave bibliografike në mënyrë korrekte dhe pa gabime. Kurrë të mos iu shkojë mendja të përdorni shkurtesa në procesin e punës! Nëse përpiqeni të kryeni punën shpejt dhe lehtë, sigurisht se më vonë do të pendoheni pse nuk e keni kryer punën e plotë herën e parë. Nuk duhet harruar se pavarësisht tipit të bibliotekës apo llojit të shërbimit bibliotekar, në fakt, automatizimi përdoret ose do të përdoret pothuajse në të gjitha shërbimet. Fundja, ju jeni bibliotekarë apo informatorë profesionalë për t'u ofruar të gjithëve qasje në informata.

PARANDALIMI I PUNËS SË DYFISHTË NË BIBLIOTEKË

Ky kriter a është i vetmi për një sistem të automatizuar të bibliotekës apo ekzistojnë ende "shenja rreziku", nga të cilat bibliotekarët duhet të kenë kujdes?

P. SUDELL: Aha! Çdo shërbim i ri informativ kërkon njerëz që të kujdesen për të. Ata njerëz çdoherë kanë nevojë të mbajnë mend strukturën e informatave ekzistuese, pavarësisht, se a janë të shtypura, manuskripte apo burimet elektronike, në mënyrë që të krijojnë dhe të gjejnë metoda hulumtuese për nxjerrjen e të dhënave. Qëllimi kryesor është se kur të punohet me sistemin e automatizuar, duhet të krijohet një rrjedhshmëri e punës efikase. Po ashtu, është shumë me rëndësi nëse është e mundur, që të parandalohet dyfishimi i një pune, të cilën e ka punuar më herët dikush tjetër në ndonjë bibliotekë të lidhur me të njëjtin sistem. Pra, puna me sistemin e automatizuar është një sfidë e

madhe që nuk përfundon kurrë. Ajo zhvillohet gjithnjë me risitë e veta. Atë dikush duhet ta ndjekë çdoherë.

Ky sugjerim duket porosi e shkëlqyer për fazën në të cilën ndodhet BKUK-ja. Po cilët janë këta "ndjekës"?

P. SUDELL: Në këtë rast "ndjekës" janë menaxherët e sistemit, të cilëve edhe u bie barra kryesore e punës. Ata kanë punën më komplekse, ngaqë duhet ta kuptojnë plotësisht sistemin dhe procesin e punës në të gjithë sektorët e bibliotekës.

Çfarë roli luan bibliotekari në ndërtimin e një shoqërie të cilës edhe i shërben? Më qartë: - Cila është rëndësia e raportit bibliotekar-lexues?

P. SUDELL: Kjo është një pyetje e vështirë. Gjithmonë bibliotekari duhet të pyes veten: - Pse unë e bëj këtë punë të veçantë? Më pas duhet të jetë i gatshëm dhe t'i lejojë vetes tolerancë, në mënyrë që t'u ofrojë përgjigjet dhe komentet e duhura të gjithë përdoruesve të shoqërisë. Është mirë të shtrohen pyetje: - Pse e përdorim Klasifikimin e Bibliotekës së Kongresit për vendosjen e librave në raftet? Pse i vendosim gazetata në mënyrë alfabetike? Pse dikush ka të drejtë të marrë në huazim librin për 28 ditë, ndërsa dikush vetëm për 7 ditë? Pastaj, bibliotekari gjithsesi duhet të pyesë veten: - A janë këto rregullat më të mira për përdoruesit? A mund të ndryshojmë diçka që mund të jetë e dobishme? Ne çdoherë kemi të kufizuar paratë dhe kohën, pra, cila është mënyra më e mirë për t'i shfrytëzuar ato? Kjo duket të jetë shumë e thjeshtë, mirëpo bërja e pyetjeve për vetveten zakonisht është në favor të zhvillimit të një biblioteke. Për këtë arsye është i pamohueshëm bashkëpunimi i stafit punonjës dhe i menaxherëve, të cilët duke diskutuar çdoherë për përmirësimin e shërbimeve me përdorues.

ÇFARË STANDARDE PËRMBAN EX-LIBRIS-I

Një kohë të gjatë veç jeni familjarizuar me sistemin ALEPH 500. Cila është filozofia e këtij sistemi?

P. SUDELL: Filozofia e Ex-Libris-it është të ndërtojë, zhvillojë dhe përkrahë programin, i cili punon se bashku me standardet e industrisë së kompjuterëve dhe me standardet informative. Në botën bibliotekare, Ex-Libris-i përkrah: MARK 21, MAB dhe UNIMARC, si dhe është mjaft i përshtatshëm për t'i përkrahur standardet lokale dhe variationet e ndryshme. Programi është i dizajnuar të përkrahë punë të ndryshme sipas kërkesave apo ambientit të blerësit. Ex-Libris-i është efikas edhe për grupe më të mëdha, si konsorciume, biblioteka kombëtare, biblioteka akademike, biblioteka speciale, etj. Përdoruesit e këtij programi mund t'i përdorin një apo shumë module, sipas dëshirës së tyre. Përdorimi i tyre nuk krijon asnjë pengesë.

Cilat janë mundësitë më të mira për të zhvilluar njohuri profesionale për ALEPH 500?

P. SUDELL: Së pari, ju ofrohet ndihmë nga vetë kompania Ex-Libris. Pastaj, është mjaft efikas edhe Rrjeti Ndërkombëtar i Përdoruesve të ALEPH-it - International Aleph User Group. Informacionet gjenden në këtë adresë: <http://sab.unisi.it/ica/wel-come.html>. Këto ofrojnë mundësi fantastike për trajnime, seminare dhe konferenca. Bashkëpunimi me Rrjetin ndërkombëtar të Përdoruesve është i domosdoshëm, sepse konsiderohet si burimi kryesor për ndihmë dhe këshilla.

Në adresën: <http://www.exlibris-group.com/docportal/logon.php>, është një portë madhështore e dokumentacionit të Ex-Libris-it, në të cilën të gjithë përdoruesit e programit Ex-Libris kanë qasje. Disa vende me numër të madh blerësish të produkteve të Ex-Libris-it, kanë grupin e tyre kombëtar për Ex-Libris. Rast konkret / vijon në faqe 12 /

mund të përmendim grupin e fuqishëm të Amerikës Veriore, që gjendet në adresën: <http://www.naaug.org/>. Adresat e dhëna më lart ndikojnë për punë më efektive me Ex-Libris-in, si dhe për të rritur dhe zhvilluar produktet e saj. Shumë anëtarë dhe koordinatorë të sistemit në Ex-Libris, qëndrojnë në rrethet kontaktues përmes listës së adresës elektronike (e-mail list), e cila ofron kontakte dhe bashkëpunim me tërë rrethet.

BIBLIOTEKA JUJAJ PO BËHET DHE "E JONA"

Si mund të përshkruani dallimin ndërmjet bibliotekës tradicionale dhe asaj të automatizuar?

P. SUDELL: Dikur Biblioteka e Manastirit me manuskriptet e saj të shumta në pergamene të lidhura, ishte bibliotekë tradicionale dhe nuk kishte nevojë për katalogim të materialeve të tilla, sepse përdoruesit e dinin çfarë përmbante biblioteka. Më vonë kjo bibliotekë u pasurua me libra të shtypur në radhitje fikse dhe në radhitje klasifikuese, kështu që çdo herë zbuloheshin diçka dhe bëhej e nevojshme për përdorim. Me këtë dua të them, se çdo periudhë në bibliotekë nxitet nga një teknologji e re. Për shembull, nëse sot kemi kohë dhe para, mund t'i digjitalizojmë të gjitha materialet e shtypura.

T'i kthehem përgjigjes - derisa biblioteka tradicionale i përket më tepër burimeve të shtypura fizike, të cilat janë të radhitura vetëm në një mënyrë, biblioteka e automatizuar, në esencë është tradicionale, sepse i radhit në shumë mënyra librat sipas programit. Kjo përsëri mbetet tradicionale. Edhe burimet informative të automatizuara, siç janë katalogët elektronikë, që ne i përdorim sot, janë plotësisht burime elektronike, mirëpo nga përbrenda janë tradicionale.

Kur bibliotekat automatizohen, burimet globale rriten në nivel botëror. Marrim si shembull rastin

tuaj! Kur ju e vëni në funksion OPAC-un, atëherë biblioteka juaj bëhet edhe e "jona". Kjo është një vlerë e veçantë, derisa burimet në vendin tuaj, siç është Kosova, shkojnë drejt automatizimit, më pas ne, si përdorues botërorë, mund të shohim se çfarë përmban biblioteka juaj. Derisa ju bëni katalogë në mënyrë mekanike, me dorë, ne të jashtëmit, nuk mund të dimë asgjë për materialet tuaja unike.

Prandaj, me rastin e automatizimit dhe futjes në funksion të Sistemit ALEPH 500, BKUK-ja bëhet burim botëror. Kjo ka një domethënie të madhe botërore. Kjo është diferenca më e madhe ndërmjet bibliotekës tradicionale dhe asaj digjitale. Brenda çdo biblioteke të automatizuar vazhdimësisht e punës ndryshon metodat e saj, ndërsa kush më mirë se sa ju mund të shikoni se çfarë jeni duke i ofruar botës dhe kush i përdor ato informacione.

Dihet takimi që patët me bibliotekarët nga Kosova. Keni ndonjë përshtypje të veçantë?

P. SUDELL: Po. Ishte një takim shumë i admiruar. Është kënaqësi dhe shumë interesant të takosh njerëz të profesionit të njëjtë nga vende të ndryshme. Në këtë takim vura re se BKUK-ja është duke hyrë në fazën fillestare të automatizimit. Personeli i BKUK-së duhet të krijojë shumë shpejt njohuri speciale.

Në ambientet tona universitare në Angli, ne përdorim gjeneratën e tretë të sistemit të automatizuar, ndërkaq, edhe përkundër të gjitha këtyre viteve të përvojës sonë, ne përsëri kërkojmë ndihmë nga kolegët tanë. Në një mënyrë, ju do të jeni nismëtarë dhe do të merreni me zgjidhjen e disa problemeve lokale. BKUK-ja i ka parashtruar vetes detyrë të madhe, shumë të madhe.

Kështu ndër veprimet që ju duhet të ndërmerri është të bëni përpjekje të keni

qasje në bazën e të dhënave, veçanërisht, në Bibliotekën e Kongresit në SHBA dhe OCLC - <http://www.oclc.org/>, si dhe në bazën e të dhënave RLG <http://www.rlg.org/index.php>. Pastaj, të fitoni qasje përmes Z39.50 tek bazat e tjera të të dhënave në ALEPH ose në ndonjë sistem tjetër të automatizuar. Ju mund të bartni burime të katalogëve për materialet tuaja, të cilat aktualisht ekzistojnë. Kjo u ndihmon juve që të mos i përpunoni dy herë katalogët origjinalë.

A e shihni ndonjë interes bashkëpunimi me BKUK-në?

P. SUDELL: Po, si jo. Kolegji Mbretëror i Londrës ka Departamentin e Studimeve të Bizantit dhe Greqisë së Re, (<http://www.kcl.ac.uk/depsta/humanities/bymogrst/>), e cila ka interes të veçantë për ballkanasit dhe për fushat e influencës greke. Gjithashtu, është Departamenti për Studime të Luftës: <http://www.kcl.ac.uk/depsta/wsg/>, që natyrisht është i lidhur me veprat për luftërat në ish-Jugosllavi, në vitet e kaluara, prandaj këtu ka fusha interesi, në të cilat përfshihen krimet e luftës. Gjithashtu, është kontakti potencial me Shkollën e Sllavistikës (Sllavonikës) dhe studimet për Evropën Lindore: <http://www.ssees.ac.uk/>, të cilat janë pjesë e Universitetit të Kolegjit Mbretëror në Londër.

Zotëri Sudell, ju faleminderit për kohën që rezervuat për BIBLIOletrën. Të përfundojmë me një përshtypje tuajën?

P. SUDELL: Shoh se ju ia keni parashtruar vetes një detyrë të rëndësishme, e cila sapo ka filluar. Gjithsesi, kjo ia vlen. Ju do të bindeni shumë shpejt se përdorimi i librave dhe i gazetave do të jetë më i madh, fondet e bibliotekës do të njihen në përmasa botërore. A nuk rezultojnë kjo në përparimet e mëtejshme?!

Intervistoi: Mr. Shukrije RAMA

Bibliotekarët dhe profesioni i tyre



Dr. BAHIE GËRBESHI-ZYLFIU

Shumë rrallë shkruhet dhe është shkruar për personalitetin e bibliotekarëve, të cilët punojnë me lexuesit edhe pse roli i tyre për bibliotekat si institucione edukative, kulturore e shkencore është i padiskutueshëm. Këta bibliotekarë janë "pasqyrë e bibliotekës", dhe prej tyre varet se çfarë respekti dhe rëndësie do të ketë biblioteka për mjedisin ku ajo gjendet. Bibliotekarët me interesimin dhe gatishmërinë e tyre mund të tejkalojnë të gjitha situatat kritike me të cilat mund të ballafaqohen gjatë punës së tyre me lexuesit. Në çdo moment bibliotekarët duhet të mbështesin të drejtën e lexuesve për të kërkuar informacion, gjithnjë duke pasur parasysh faktin se të drejtë për shfrytëzimin e informacioneve kanë të gjithë anëtarët e shoqërisë pavarësisht nga mosha, raca, kombësia, feja, gjinia etj.

Sipas Deklaratës së OKB-së për të drejtat e njeriut çdo njeri ka të drejtën e lirisë së bindjeve të tij dhe të drejtën e të shprehurit lirshëm. Me këtë është e siguruar e drejta e

çdo individ, që pa pengesë, të mbështes bindjet e tij dhe të kërkojë lirshëm të marrë dhe të shpërndajë informacion dhe ide nëpërmjet çdo lloji mjeti dhe pavarësisht nga kufizimet shtetërore. Bibliotekarët profesionistë kanë obligim që të promovojnë dhe të mbrojnë lirinë intelektuale në çdo moment.

Prej shekullit të XIX, kur në biblioteka kanë filluar të zhvillohen shërbimet informative-instruktive e referale, e deri në ditët tona, dy çështje kanë mbetur esenciale:

- *funksioni themelor i bibliotekës* (ndihmë lexuesve për tejkalimin e barrierave midis tyre dhe informacioneve)
- *procesi themelor i punës* (identifikimi dhe sqarimi i pyetjeve dhe kërkesave të përdoruesve; edukimi dhe ndihma lexuesve në gjetjen dhe seleksionimin e informatave dhe mënyrën e shfrytëzimit të burimeve informative)

Funksioni themelor i bibliotekës dhe procesi themelor i punës, kanë mbetur aktuale dhe janë detyrë e obligim i përhershëm i bibliotekarëve. Mbarëvajtja e punëve varet edhe nga numri dhe kualifikimi i bibliotekarëve-informatorë, të cilët duhet t'i përgjigjen secilës pyetje të lexuesve.

ÇFARË BIBLIOTEKARI DËSHIROJNË LEXUESIT?

- Bibliotekari, i cili punon me lexues ka për detyrë që kërkesës së lexuesit t'i jep përgjigje të saktë, relevante dhe të shpejtë;

- Bibliotekari ka përgjegjësi të madhe që në mënyrë adekuate të prezantojë punën me përgjegjësi dhe të mundimshme të kolegëve të vet;

- Bibliotekari duhet të përcjellë të gjitha risitë në fushën e informacionit, në mënyrë që t'u përgjigjet kërkesave dhe nevojave të lexuesve të shkaktuara nga "eksplozimi" i shkencës dhe teknologjisë së re, dhe sipas tyre ta përshtatë sistemin e punës, sepse prej kësaj varet edhe efikasiteti i shërbimit informativ;

- Bibliotekari duhet të përcjellë edhe të gjitha ndryshimet brenda shërbimit bibliotekar - informativ dhe në bazë të kërkesave të të tjerëve, të vërtetojë mënyrën e vet të punës dhe të arriturat e njohurive për përpimin e punës në proceset e veçanta informative;

- Për bibliotekarin, të gjithë lexuesit janë të njëjtë dhe të gjitha kërkesat janë njësoj të rëndësishme;

- Detyra kryesore e bibliotekarit është që të lehtësojë punën e lexuesve dhe të ndihmojë lexuesit e tij;

- Bibliotekari duhet të lidhë librin me lexuesin dhe lexuesin me librin e tij;

- Bibliotekari assesi nuk guxon që pyetjes së parashtruar të lexuesit t'i përgjigjet prerazi me - Jo;

- Ç'do ndihmë lexuesit duhet t'i ofrohet në mënyrë diskrete,

/ vijon në faqe 14 /

pa qëndrim superior ndaj lexuesit, sepse bibliotekari duhet të jetë "i edukuar dhe i informuar, e jo pretenzioz".

- Vendi i punës së bibliotekarit nuk është sinekurë për shkencëtarët. Qëllimi i bibliotekarit është që t'ua lehtësojë punën shkencëtarëve - lexues.

Këto karakteristika nuk i përmban asnjë sistematizim, por do të ishte mirë që t'iu shërbejnë bibliotekarëve që punojnë me lexues, që të testojnë personalitetin e tyre dhe ta dinë se sa janë të gatshëm të kryejnë obligimet dhe detyrat e profesionit të tyre. Prandaj secili që ka pranuar këtë obligim duhet të pyesë veten se a është apo jo i zoti që të kryejë detyrat e tij me sukses dhe nderë. Pra, bibliotekari çfarë i duhet një biblioteke, duhet t'i dojë njerëzit, librat por edhe të mbajë rendin. Puna me lexues dhe për lexues është obligim i madh, ngarkesë por edhe kënaqësi. Bibliotekari që punon me lexues duhet të jetë inteligjent, i saktë, i aftë dhe i qartë. Ai, përveç që duhet të ketë njohuri profesionale, duhet të ketë edhe

taktikë, memorie të zhvilluar, interesim për lexues, shkathtësi dhe durim.

Studiuesi Johan D. Cowley, shërbimin informativ e ka përkufizuar si situatë vazhdimisht kritike, e cila fillon prej momentit kur dikush dëshiron të dijë diçka. Numri i këtyre "situatave kritike" me të cilat bibliotekari duhet të ballafaqohet, varet edhe prej numrit dhe kualifikimit të bibliotekarëve dhe nivelit të organizimit informativ. Tejkalinim e këtyre situatave më së shumti mund ta ndihmojë gatishmëria e vetë bibliotekarëve edhe pse shumica e tyre nuk janë të kënaqur me vlerësimin e punës dhe statusin e tyre profesional e social.

Bibliotekari, në raste të shpeshta, qëndron ndërmjet lexuesit dhe librit, dhe prej tij, si ndërmjetësues, kërkohet që të vërë në kontakt librin me lexuesin, edhe pse çdo libër e ka lexuesin e vet apo çdo lexues e ka librin e vet. Nëse lexuesi e di, cili është libri i tij, atëherë bibliotekari e ka rolin e shërbyesit, por, kur lexuesi ka kërkesa rreth një problemi zgjidhja e të cilit fshihet në ndon-

jërin prej librave, atëherë bibliotekari merr rolin e hulumtuesit dhe duhet të kërkojë fondin për të gjetur literaturë relevante për nevojat konkrete të lexuesit. Vetëm ky "lloj" bibliotekari mund ta kryej punën e tij me nder dhe është i dëshirueshëm nga lexuesit. Bibliotekarit nuk i duhet reklama për të zgjeruar veprimtarinë e tij. Çdo sjellje e tij lë një përshtypje të caktuar te lexuesit që kërkojnë ndihmën e tij. Bibliotekari promovon sjelljet e tij, në çdo ditë punës së tij derisa e kryen një detyrë. Sjelljet e tij nuk mbesin jashtë vështrimit të të tjerëve. Reklamë mund të jetë vetë sjellja e tij. Kur lexuesi del i kënaqur me shërbimin e bibliotekarit duke e pasur të ditur se mund të kërkojë ndihmë profesionale në çdo kohë, ai kënaqësinë e tij ua përcjell të tjerëve dhe kështu u siguron bibliotekarëve të mirë lexues të rinj.

Bibliotekarët duhet të angazhohen për ridefinimin e profesionit të tyre.

Neve nuk na nevojiten të dhëna të detaizuara të zhvillimit të profesionit të bibliotekarisë, sepse nuk e shohim të arsyeshme të përsërisim tërë ato fakte të njohura, të cilat dëshmojnë për rëndësinë që pati fjala e shkruar. Flasin për rolin e atyre që kanë mbledhur dhe ruajtur dokumente të shkruara, për një numër personalitetesh të njohur: shkencëtarë, filozofë, letrarë e poetë, të cilët e kanë trasuar rrugën dhe kanë vënë themelet e profesionit të bibliotekarisë, dhe për fat kanë mundësuar që shumëçka të ruhet deri në ditët tona. Disa bibliofilë, mbledhës të flaktë të librave, kudo qofshin shkruar e botuar ato, pa marrë parasysh se cilëve popuj u takonin dhe në ç'gjuhë ishin shkruar, kanë lënë gjurmë në formë udhëzimesh, për formimin e bib-



liotekave (Gabriel Naude), katalogjeve (R. Clement) dhe rregulla për përpunim (Antonio Panizzi), bibliografinë e inkunabulave (Ludvig Hain), formimin e katalogjeve të shtypura (Leopold Delisle), etj. Shumica prej këtyre kanë qenë këshilltarë me ndikim në oborret mbretërore dhe ndihmonin shumë veprimtarinë shkencore dhe botuese. Dituritë që ata i zotëronin, talentin, rolin dhe vendin që kishin në shoqëri dhe rrethanat e përgjithshme të asaj kohe, kanë ndikuar shumë që bibliotekat të bëhen institucione të larta shtetërore dhe të parat në edukim, shkencë dhe kulturë.

Bibliotekarët, qysh prej fillimit të krijimit të profesionit të tyre, është dashur që të kenë njohuri të përgjithshme, para se gjithash njohjen e gjuhëve të huaja. Prej gjysmës së dytë të shekullit të XIX ka filluar edukimi i kuadrit bibliotekar. Janë hapur shkollat e para pastaj ato të larta, për aftësimin profesional të bibliotekarëve. Bibliotekari gjithmonë është dashur që të mësojë, të ketë njohuri universale, që në punën e tij të bashkojë rolin e mësuesit, shkencëtarit e këshillëdhënësit. Kohërat kanë ndryshuar, dituritë janë rritur me anë specializimesh të ndryshme, kurse në biblioteka pyetjet gjithmonë iu drejtohen bibliotekarëve. Krahas zhvillimit të teknologjive të reja dhe vërshimit të madh informativ, bibliotekari është i detyruar që përsëri

të mësojë që të mund të jetë në gjendje të përballojë punën e tij dhe t'u përgjigjet pyetjeve të përdoruesve.

Tash, bibliotekarët duke shfrytëzuar kushtet dhe rrethanat e reja, duhet të angazhohen për ridefinimin e profesionit në tërësi, gjithnjë duke pasur parasysh se natyra e punës dhe filozofia e profesionit të bibliotekarit po ndryshojnë vazhdimisht dhe në mënyrë drastike. Për t'i përballuar sa më me sukses këto ndryshime, janë të nevojshme njohuritë plotësuese dhe përvoja të reja. Bibliotekarët e vendeve të zhvilluara para disa viteve kanë



konstatuar se profesioni i bibliotekarisë ka rastin që të bëhet menaxhuesi kryesor në shoqërinë e informacionit. Futuristët parashohin që edhe gjatë këtij shekulli të ri, kur teknologjia do të ndryshojë me shpejtësi edhe më të madhe se në të kaluarën, "libri dhe bibliotekarët do të ekzistojnë dhe do t'i shërbejnë njerëzimit, prandaj, do të ketë nevojë edhe për bibliotekarët".

Edhe bibliotekaria në Kosovë po synon të hyjë në një fazë, e cila në botë quhet information highway, dhe që konsiderohet si parakusht për përparim dhe zhvillim të gjithmbarshëm të shoqërisë. Këtë rast vërtet të veçantë, bibliotekaria jonë nuk guxon ta lëshoj, sepse shumë lehtë do të formohet sistemi informativ paralel që do të ketë rolin e menaxhuesit.

Këtë transformim në bibliotekari, i cili është realizuar në shumë vende të botës, me shumë sukses, nuk mund ta bëjnë vetëm bibliotekarët. Kjo mund të arrihet vetëm me bashkëpunim dhe ndihmë reciproke të të gjitha institucioneve të rëndësishme shtetërore.

Shteti duhet të kujdeset për shkollimin e kuadrove, të stimulojë përsosshmërinë profesionale dhe arrijen e njohurive të reja profesionale dhe shkencore në fushën e bibliotekarisë, të përfillojë punën dhe rezultatet e ekspertëve dhe institucioneve, të kujdeset për gjendjen e tyre sociale dhe materiale. Pa ndihmën e shoqërisë, bibliotekat nuk mund t'i marrin përgjegjësitë as për zhvillimin e vet, e të mos flasim për zhvillimin e përgjithshëm të shtetit.

Lidhur me profesionin e bibliotekarisë, pajtohem me mendimin e William Marsterson i cili në librin e tij "Information Technology and the Role of the Librarian", botuar në Londër, në vitin 1987, bibliotekarët e shekullit XXI i sheh si "kuratorë, edukatorë e informatorë".



SYLEJMAN PIREVA

BIBLIOTEKA DHE MISIONI

Funksioni i bibliotekës as nuk duhet dhe as nuk bën të kuptohet si një veprim i ngushtë, statik dhe i kufizuar në hapësirë dhe në kohë. Apo, nuk duhet të kuptohet si gjithçka që ngjan në të dhe sikur gjithçka duhet të silllet vetëm përreth boshtit të tij, sepse atëherë do t'i ngjasonte shumë pusit me ujë, i cili rri në një vend dhe nuk lëviz. Duhet të ndodhë e kundërta, zhvillimi dhe krijimi i bibliotekës, duhet të përshkohet nga dinamizmi i pandalshëm, thënë figurativisht, duhet t'i ngjasojë pikërisht deltës së lumit, që çel brazda të shumta dhe në shumë drejtime, duke çarë gjithnjë përpara dhe pa u ndalur asnjëherë.

Jo rastësisht këtë thamë Udhëtimi i bibliotekës përtej mureve të saj, sepse thesarin që mban përbrenda, nuk duhet ta ruajë të konservuar, por duhet ta nxjerrë jashtë për shfrytëzim, përveç ekzemplarëve të rrallë dhe unikatë.

Fjala është për shërbimin e përdoruesve me literaturë dhe material tjetër, që është detyra numër një e çdo biblioteke dhe është misioni kryesor i saj. Patjetër, rëndësi kanë edhe format e tjera të punëve të përditshme, siç janë njohja dhe zbatimi i metodave dhe i standardeve ndërkombëtare për përpunimin e librit, të periodikut dhe të çdo materiali tjetër të shtypur a audio-vizual.

Çuditërisht, të gjitha këto nuk do të vlenin aq shumë, sikur të mos kujtonim punët që kryhen në emër të përdoruesve, të brezave të tashëm dhe të ardhshëm.

Biblioteka është vendi ku mblidhet, përpunohet dhe ruhet ky material, por lexuesit dhe përdoruesit i japin kuptim të plotë misionit të saj.

Udhëtimi i bibliotekës përtej mureve të saj

UDHËTIMI PËR NË FAMILJET E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Të gjitha këto që u tha më lart, u takojnë lexuesve dhe përdoruesve të aftë dhe të shëndoshë, të cilët pa pengesa i qasen bibliotekës për t'u shërbyer me materialin e nevojshëm. Në shumë raste ata mund t'i huazojnë librat dhe materialin tjetër në shtëpi ose mund ta shfrytëzojnë në sallën e bibliotekës.

Lind pyetja: - Si të veprohet me lexuesit që nuk kanë mundësi fizike për të shkruar në bibliotekë, konkretisht, me personat me aftësi të kufizuara, me aftësi të përkohshme ose me kohëzgjatje më të madhe?

Në çdo shtet normal dhe në çdo shoqëri të organizuar, bibliotekat do të duhej të jenë të parat, të cilat duhet t'u dalin në ndihmë kësaj kategorie shoqërore. Nëse këta persona nuk janë në gjendje që të shkojnë në bibliotekë, atëherë biblioteka duhet të arrijë te ata, pra në shtëpitë e tyre.

POROSIA ME TELEFON DHE POSTË ELEKTRONIKE

Që të funksionojnë si duhet këto metoda, do të mjaftonte që personat me aftësi të kufizuara ta dinë numrin e telefonit të bibliotekës dhe ta kërkojnë librin a materialin, që u duhet, kurse biblioteka, domosdo, duhet të interesohet dhe të obligohet t'ua shpjerë materialet në shtëpi. Porosia njësoj mund të bëhet edhe me postë elektronike, duke e kryer porosinë përmes internetit, të cilin, në rrethanat e sotme në Kosovë, mund ta ketë ose të mos e kenë lexuesit a bibliotekat, por do duhej ta kishte çdo bibliotekë dhe lexues, sepse, sot, kjo është plotësisht e mundshme dhe e domosdoshme. Ky gjest dhe veprim i bibliotekës nuk duhet të kuptohet si vullnet i mirë dhe human, por edhe si detyrë dhe obligim, sepse vetëm kështu bëhet e mundshme, që kjo shtresë njerëzish të mos shkëputet nga biblioteka, thënë më drejt, nga miku i tyre, libri, i cili mbetet i pazëvendësueshëm në çdo kohë, është më i lehti dhe më i përdorshmi, sidomos, kjo u përshatet më së miri vetë këtyre personave.

A thua janë duke i bërë këtë punë bibliotekat tona dhe a janë duke vepruar në këtë mënyrë? Kjo praktikë deri më sot nuk është bërë e njohur ndër ne.

OBLIGIMET QEVERTARE DHE BIBLIOTEKARE

Nëse kjo nuk është praktikë e njohur ndër ne dhe nuk u ka shkruar për dore qeverisë bibliotekave tona deri tashti, nuk do të thotë në asnjë mënyrë se duhet të presin më gjatë dhe të mos ia nisim fare. Bibliotekat e vendeve të tjera të përparuara, këtë metodë të shërbimit ndaj përdoruesve të kësaj kategorie e kanë filluar qysh herët dhe kanë krijuar një traditë shumë të begatshme. Kjo ka funksionuar me mjaft sukses, sepse për këtë kanë rënë në ujdë bibliotekat së bashku me qeveritë e vendeve të tyre. E njëjta gjë duhet të ndodhë edhe me bibliotekat dhe qeverinë tonë, gjegjësisht, me qeveritë lokale. Kuptohet se kjo nuk është punë aq e lehtë për t'u kryer, sepse kërkon angazhim të posaçëm, jo vetëm të një punonjësi të bibliotekës, por është punë e shumë vetave, madje, kërkon edhe shpenzime. Për t'ua dërguar këtyre personave një libër a material tjetër, në mënyrë të rregullt, prej një skaji në skajin tjetër të qytetit, patjetër, lypsen edhe shpenzime. Shpenzime po, por që ia vlejnë.

UDHËTIMI PËR NË INSTITUCIONET E VEÇANTA

Bibliotekat munden dhe janë të obliguara të kryejnë shërbime për përdoruesit edhe në forma të tjera. Janë disa institucione dhe ndërmarje të ndryshme, punonjësit e të cilave kanë nevojë, por edhe mundësi për shfrytëzimin e literaturës së llojeve dhe të gjinive të ndryshme, por që u mungon dhe nuk e kanë të lehtë ta sigurojnë çdo herë kur u nevojitet ajo, ose rrallëherë e sigurojnë ose nuk e sigurojnë fare. Prandaj, bibliotekat janë ndër të parat që munden dhe duhet t'u dalin në ndihmë dhe t'iu ofrojnë shërbime këtyre njerëzve.

Në këtë drejtim ka pasur disa përpjekje, por të pamjaftueshme nga ndonjë bibliotekë, siç është Biblioteka "Hivzi Sulejmani" e Prishtinës, e cila ka dërguar në dy raste me qindra libra në tri gjuhë: Burgut të Prishtinës, si dhe oferta e bërë për TMK-në. Këso shërbimesh mund t'u ofrohen edhe spitaleve për pacientët e tyre, kopshteve të fëmijëve dhe ndonjë institucioni tjetër.



LAVDIJE RRAHMANI

E ballafaquar me vështirësi për sigurimin e materialeve bibliotekare, BKUK kishte nevojë urgjente për hartimin e një projekti për pasurimin e fondeve të saja. Për të realizuar hartimin e një projekti të tillë, i cili do të siguron të dhëna nga botuesit kosovarë për të gjitha publikimet, që nga fillimi i funksionimit të tyre si botues, së pari ishte i nevojshëm hartimi i një projekti të punës - i konceptuar mbi bazën e një komunikimi të drejtpërdrejtë me botuesit. Ky komunikim mes përfaqësuesve të BKUK-së dhe botuesve, është projektuar mbi idenë e:

Interpretimit të ligjit për bibliotekat, të miratuar nga Parlamenti i Kosovës, dhe mbi mundësitë për pasurim të koleksioneve që ofron ky ligj, nëpërmjet Ekzemplarit të detyrueshëm;

Hulumtimit të mundësive për pasurimin e fondeve të BKUK-së.

Ky projekt është ndarë në katër faza, të cilat mund të realizohen brenda periudhës gjashtëmujore.

Faza e parë ka përfshirë takimet me botues, të cilët sipas dinamikës së botimeve, i takojnë grupit të parë të botuesve dhe konsiderohen

botuesit më të mëdhenj në Kosovë;

Faza e dytë do të përfshijë takimet me botues, të cilët konsiderohet të kenë një sasi mesatare botimesh brenda vitit ku do të përfshihen edhe botuesit e teksteve universitare;

Faza e tretë do të jetë faza në të

Pasurimi i koleksioneve të BKUK-së me botimet nga Kosova

cilën planifikohet të realizohen takime me botuesit me një sasi më të vogël të publikimeve brenda vitit - këtu hyjnë edhe Personat botues;

Faza e katërt do të përfshijë mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, si dhe nxjerrjen e rezultateve konkrete, përfundimtare, lidhur me botimet që i mungojnë fondit të BKUK-së. Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave do të pasojë me hartimin e një plani strategjik të veprimit në të ardhmen, që do të bënte të mundur të sigurohen botimet e botuesve të Kosovës, të cilat u mungojnë fondeve të BKUK-së. Kjo do të ketë një rëndësi të veçantë, meqë gjatë periudhës reth dhjetëvjeçare të administrimit të dhunshëm të BKUK-së, nuk ka ekzistuar mundësia për pasurimin e fondeve me këto publikime.

Në fazën e parë të këtij projekti janë realizuar takime me 13 botues: Rilindja, Dukagjini, Rozafa, Era, Faik Konica, Libri shkollor, Instituti Albanologjik, ASHAK, Zëri, Gjon Buzuku, Enti i teksteve, KIPRED. Gjatë këtyre takimeve janë zhvilluar biseda si dhe janë shtuar çështje të mbështetura në konceptin e këtij projekti. Për shkaqe objektive nuk janë realizuar takime me shtëpitë botuese: UP, Verana dhe Pika A5.

BOTUESIT - RËNDËSIA E LIGJIT PËR FUNKSIONIN E EKZEMPLARIT TË DETYRUESHËM

Gjatë takimeve me botues, atyre u është ofruar një pasqyrë e saktë e të dhënave për gjendjen aktuale të funksionimit të Ekzemplarit të detyrueshëm. Të gjithë botuesit (me ndonjë përjashtim të vogël - shih tekstin në vazhdim) me të cilët janë zhvilluar biseda, tash e tutje janë treguar të gatshëm të bashkëpunojnë dhe t'i shlyejnë obligimet ndaj BKUK-së duke dorëzuar nga 5 ekzemplarë për secilin publikim brenda afatit të caktuar sipas ligjit për bibliotekat.

Shumica e këtyre botuesve kanë informacion të mjaftueshëm sa i përket

ligjit për bibliotekat dhe rëndësisë së funksionimit të Ekzemplarit të detyrueshëm. Bisedat e zhvilluara kanë pasuar me rezultate: janë intensifikuar kontaktet me botues, duke shkëmbyer informacione me interes për të dyja palët në mënyrë që të funksionojë Ekzemplari i detyrueshëm ashtu siç është paraparë me ligj.

Të disa botues vërehet një shpërfillje ndaj

obligimit ligjor që t'i dërgojnë bibliotekës botimet e tyre si pjesë të Ekzemplarit të detyrueshëm. Ata kryesisht pajtohen me rëndësinë e ruajtjes në BKUK të materialeve që botojnë, mirëpo në përgjithësi hezitojnë të dorëzojnë Ekzemplarin e detyrueshëm të sapo botuar për shkak të keqpërdorimeve të mundshme. Ankesa serioze kanë sidomos botuesit e materialeve shkollore, të cilët kanë paraqitur qartë shkaqet për hezitimin e tillë, disa nga të cilat janë:

- botues të papërgjegjshëm botojnë të njëjtin titull (para se ai të botohet nga botuesi i autorizuar) pa qenë të autorizuar nga institucionet përgjegjëse;
- ndonjë botues a individ falsifikon tekstin shkollor duke e nxjerrë në treg në emër të botuesit legjitim;
- ndonjë botues a individ mrit numrin e ekzemplarëve të një teksti, pa lejen e botuesit legjitim;

Kërkesën e BKUK-së për sigurimin e informacionit reth titujve që janë në plan për t'u botuar brenda vitit, disa prej botuesve e pranojnë me druajtje. Disa botues janë treguar të gatshëm për bashkëpunim dhe kanë ofruar informacione për planet e tyre të botimeve në perspektivë, ndërsa disa të tjerë kanë hezitur të ofrojnë planin e tyre të botimeve, për shkak të problemeve të caktuara.

HULUMTIMI I MUNDËSIVE PËR PASURIMIN E FONDEVE TË BKUK-SË

Sa i përket pikës së dytë të projektit, gjatë kontakteve të drejtpërdrejta me botues janë vlerësuar qëndrimet e botuesve për gatishmërinë e tyre për të siguruar të gjithë titujt për të cilët BKUK shpreh interes t'i ketë si pjesë të koleksioneve të saj, duke përfshirë veçanërisht plotësimin e mungesave me tituj që janë botuar nga botuesit në Kosovë.

Është mjaft e rëndësishme se janë siguruar katalogët e botimeve të publikuara që nga viti 2000 e këndeje nga disa botues, si: Dukagjini, Faik Konica dhe ASHAK, kurse nga botues të tjerë është premtuar se do të sigurohen të dhënat për serinë e botimeve të tyre. Sigurimi i këtyre katalogëve do të bëjë të mundur evidencimin e titujve që i mungojnë fondit të BKUK-së, duke krahasuar ata me informatat që dalin nga skedarët.

"Faik Konica"	

Organizimi i muzikaleve në bibliotekë



EDONA MUNISHI

Avancimi i teknologjisë informative është bërë objekt diskutimesh, hulumtimesh e studimesh në shumë fusha të dijës. Temat më të shpeshta të trajtimit lidhur me përparimin e teknologjisë informative sillen rreth dobive dhe dëmeve eventuale që sjellin ato në shoqëritë e kësaj kohe. Ajo që është duke e krijuar një gjendje dyshimi ka të bëjë me formën tradicionale të informimit, të arritjes së dijës e që kryesisht bëhej përmes librit, pra përmes shkrimit. Tani në këtë kohë sikur ka ndryshuar mënyra e komunikimit mënyra e pranimit të informacionit po edhe mënyra e njohjes së botës dhe e përfitimit të dijeve në përgjithësi. Kjo gjendje ka shkaktuar një sasi frike për nevojën e pranisë së institucioneve kulturore siç janë bibliotekat, muzetë, shtëpitë operistike, sallat koncertale etj. Mirëpo, ka një pjesë të mirë të njerëzve që këtë konkurrencë e shohin më shumë në favor të institucioneve që i përmendëm. Njohësve të teknikës dhe muzikédashësve u është e njohur rruga e zhvillimit të mjeteve të fiksimit-incizimit dhe të pranimit të tingullit-muzikës gjatë kohës. Dhe, që nga paraqitja e gramafonit, më pas magnetofonit, radio e televizionit, droja se muzika si art po humb përjetimin e gjallë, dhe se po bëhet material i teknikës, nuk ka pushuar, por koha gjithnjë ka demantuar skeptikët se të mirat që ka sjellë ky proces janë tepër të qarta dhe evidente në tërë zhvillimin e muzikës në përgjithësi nga fillimi i shek.

XX e këtëj. Është kohë e digjitalizimit të tingullit dhe akustikës në përgjithësi. Një arritje shumë të madhe të mjeteve incizuese e reprodukuuese të muzikës ka bërë ndikim të dukshëm edhe në mënyrën e pranimit dhe të përjetimit të muzikës si art ose si veprimtari argëtuese. Prania e internetit në shikim të parë mund të duket se ka larguar lexuesin nga libri, muzikédashësin nga dëgjimi i muzikës etj., mirëpo, nëse me vëmendje bëhet një analizë serioze do të shihet angazhimi për ta pasur librin në sirtarët e organizuara, por edhe muzikën në sirtarët e saj special. Tash kur jemi në erën e informacionit, i interesuari ka mundësi të lehtë e të shpejtë të njihet me mënyrat e organizimit muzikor në bibliotekat më të njohura botërore. Në këtë kontekst edhe unë hapa internetin dhe arrita të depërtoj në disa biblioteka të njohura. Në kërkim të informacioneve hyra në Bibliotekën Nationale Franceze (Bibliothèque Nationale Française) në Bibliotekën e Vjenës, po edhe në disa biblioteka të Kroacisë dhe në të gjitha këto po edhe në shumë të tjera kuptova se ka një pasuri të jashtëzakonshme muzikore po gjithashtu ka një organizim të veçantë të tërë asaj pasurie të vendosur në ato biblioteka. Ajo që është e dukshme dhe e përbashkët për të gjitha këto biblioteka është prania e Departamentit të veçantë të muzikës dhe në kuadër të tij pastaj bëhet organizimi i sektorëve të këtij departamenti. Pak e entuziazmuar, por më shumë e nxitur sikur mora guximin që edhe në kushtet dhe rrethanat në të cilat vepron Biblioteka Kombëtare Universitare e Kosovës të shfaqë mendimet e mia rreth mundësive për një organizim më bashkëkohor të fondeve muzikore dhe shfrytëzimit të tyre në këtë institucion. Në krahasim me bibliotekat e tjera evropiane e botërore prania e fondeve muzikore në bibliotekën tonë është fare modeste dhe historiku i grumbullimit të

këtij fondi është shumë shumë i vonshëm. Është e njohur se në mjedise kulturore evropiane, vendosja e muzikës në formë të organizuar-institucionale nisë që nga gjysma e shekullit XIX. Dhe, kur marrim e shfletojmë nismat e vendosjes së literaturës muzikore, incizimeve muzikore etj., në bibliotekat e mjedisve më të përparuara shohim se institucionin tonë e pret një punë e madhe dhe një angazhim tepër serioz.

DIGJITALIZIMI I MATERIALEVE

Dihet se Biblioteka Kombëtare Universitare e Kosovës ende është në fazën e konsolidimit në të gjitha aspektet e veprimit. Ky konsolidim përfshin edhe fondet muzikore që janë aty. Me angazhimin e punonjësve të bibliotekës, në vitin që shkoi është arritur që të konstatohet gjendja e materialeve muzikore që ndodhën në këtë institucion dhe, të evidentohen fondet sipas kritereve të bibliotekarisë. Nga ai regjistrim është konstatuar një prani modeste e këtyre fondeve. Mirëpo, sado që të jetë sasish ai material muzikor, kërkon një përkujdesje në mënyrë që ai të ruhet dhe të jetë në shërbim të të interesuarve. Përveç kësaj, siç është detyrë dhe punë e bibliotekave edhe këtu duhet vazhduar me angazhim shumë më të madh në pasurimin e fondeve muzikore të të gjitha llojeve. Meqë, gjithnjë po flitet për avancimin e mjeteve teknike të incizimit këtij zhvillimi i nënshtrohet edhe materiali-fondet muzikore që vendosen në biblioteka. Prandaj, për t'u arritur një kërkesë e kohës dhe për t'i siguruar edhe më mirë ato fonde kërkohet që urgjentisht të bëhet digjitalizimi incizues i tërë materialeve që gjenden momentalisht në bibliotekë për ta pasur më të lehtë vazhdimin e këtij procesi me amaterialet e tjera që do të sigurohen me kalimin e kohës. Kjo

nevojë bashkëkohore kërkon edhe krijimin e disa kushteve teknike që duhet plotësuar institucioni i bibliotekës. Për t'u arritur standardi i digjitalizimit të materialeve në radhë të parë është e domosdoshme pajisja me kompjuter shumë cilësor që i bashkëngjiten të gjitha pjesët e nevojshme incizuese, kurse vetë digjitalizimin e materialeve duhet ta bëjë individi i specializuar për një punë sa më cilësore.

PËR NJË TRAJTIM TË VEÇANTË TË MUZIKALEVE

Muzika nga vetë karakteri i saj i zëshëm (tingullor) ka një specifikë të veçantë të shfrytëzimit nga i interesuari. Ajo kërkon një ambient pak më të dallueshëm nga fondet e tjera të vendosura në bibliotekë. Për t'u bërë një punë me standardet e kërkuara të kësaj kohe është e nevojshme krijimi i kushteve jo vetëm teknike po edhe hapësinore, e kuadrosh etj. Lëmi i muzikës është një fushë e gjerë dhe përfshinë tri veprimtaritë kryesore të saj: krijimtarinë, shkrimin për të dhe realizimin dhe secila nga këto veprimtari nëngrupohet në aktivitete të tjera që i takojnë muzikës. Në kudër të institucionit të bibliotekës është me interes që të formohet departamenti i muzikës si njësi e veçantë. Në kuadër të këtij organizmi të brendshëm do të shtrihet aktiviteti i sigurimit dhe shfrytëzimit të materialeve muzikore. Departamenti që kërkohet të jetë i veçantë, po ashtu kërkon të ketë hapësirë të veçantë dhe adekuate e destinuar vetëm për materialet muzikore të të gjitha karaktereve. Do të ishte e preferueshme që mundësisht hapësira e dedikuar të jetë e madhe në mënyrë që të ofrojë sidokudo një komoditet të favorshëm për punë. Në këtë hapësirë do të vendoseshin fondet me kriteret dhe standarde të përcaktuara.

Literatura e shkruar për muzikën ku përfshihen librat, revistat, fjalorët, enciklopeditë etj., përbëjnë një pjesë të madhe e këtij ambienti. Vendosja e këtyre fondeve bëhet me kriteret e përcaktuara për librin në përgjithësi. Prandaj, duhet siguruar vitrinat e përshtatshme ku do të vendoseshin librat, fjalorët, enciklopeditë etj. Këto vitrina mund të jenë të hapura ose të mbyllura.


Krahas vitrinave për vendosjen e librit nevojiten edhe vitrinat e posaçme në të cilat do të vendoseshin muzikalet - që nënkupton krijimtarinë muzikore pra notat ose partiturat e të gjitha llojeve të krijimtarisë muzikore. Në konsultë me dizajner profesionist do të punoheshin oramarët ku do të renditeshin notat, dorëshkrimet, fotografitë e kompozitorëve, katalogjet, programet e koncerteve, festivaleve etj. I tërë ky material që do të ishte i pranishëm në këdo kënde të hapësirës muzikore do të ofrohej në përdorim të të interesuarve dhe për këtë po ashtu duhet krijuar mundësi shfrytëzimi. Kështu për ta lexuar, konsultuar, po edhe për ta bërë të përdorshëm nevojiten dy-tri e më shumë karrige me tavolina të veçanta. Një aparat fotokopjues, është po ashtu i domosdoshëm.

Fonoteka paraqet tërë pasurinë e zëshme (fonike) audio e audiovizuale që përfshinë të gjitha llojet e incizimeve. Në fonotekë ka disqe që dikur ishin në përdorim, audiokaseta, videokaseta, dhe tani CD - incizime dhe të gjitha këto klasifikohen, sistemohen dhe renditen nëpër raftet e përshtatshme për t'i gjetur dhe për t'i dhënë në shfrytëzim. Është e domosdoshme që në fillim i tërë materiali të digjitalizohet dhe kjo është një ndër detyrat e para të të punësuarve në Bibliotekë. Materiali i digjitalizuar - i vendosur në CD incizime si dhe materiali i cili është në CD, i nënshtrohet kriterëve standarde të vendosjes. Për këtë punë duhet përgatitje të rafteve të veçanta adekuate e tipike për CD incizime, duke pasur parasysh mundësinë sa më të lehtë të shfrytëzimit.

HAPËSIRA - KËNDI I DËGJIMIT TË MUZIKËS

Muzika e koleksionuar dhe e vendosur në bibliotekë përveç që ka karakter të konservimit - ruajtjes ka edhe karakterin

e shfrytëzimit të materialit. Misioni i saj është që ajo të jetë sa më afër shfrytëzuesit të interesuar. Komunikimi me muzikën në bibliotekë, ka një peshë të caktuar dhe merr një dimension qoftë edhe psikologjik. Shfrytëzimi i muzikës dhe i materialeve muzikore në bibliotekë bëhet për ta përjetuar, për të marrë informacione, për ta analizuar e studiuar. Këndi i veçuar për dëgjim të muzikës duhet së pari të pajiset me aparate bashkëkohore të dëgjimit. E kjo nënkupton që të veçohen mundësisht dy kabina të veçanta të izoluar, me dy tavolina, me kompjuterë, videoaparaturë etj. Shfrytëzimi do të bëhet nga anëtarët e bibliotekës me kartelat e anëtarësimit kurse dëgjimi muzikës së kërkuar do të ofrohej nga të punësuarit në bibliotekë sipas kërkesave të të interesuarit. Në mjaft



biblioteka evropiane tash më gjenden edhe studio incizuese të përgatitura mirë që shërbejnë për incizimin e materialeve muzikore karakteresh të ndryshme. Me një konsideratë për muzikën si art, si shkencë e kulturë, do të dalë se çdo investim në krijimin e këtyre standardeve jo vetëm që do t'ia ngritë peshën e vetë institucionit të bibliotekës por edhe, do ta tërheqë, të interesuarin për muzikë në hapësirat e këtij institucioni misioni i të cilit pikërisht është që muzika në çfarëdo forme qoftë të jetë sa më pranë muzikëdashësit, lexuesit, hulumtuesit e studiuesit të muzikës.

Sfidat e qendrës së restaurimit dhe të konservimit të BKUK-së

BEDRIJE MEKOLLI & BLERTA SLISHANI

Shumë libra e materiale të tjera bibliotekare u ekspozohen dëmtimeve nga lagështia, insektet, brejtësit dhe dëmtuesit e tjerë, sidomos në vendet e deponuara në kushte relativisht të papërshtatshme. Në rrethana dhe kushtet tona, mbrojtja, por dhe restaurimi i materialeve, do të jetë i kushtëzuar nga investimi që do të bëhet për përgatitje profesionale të stafit dhe të pajisjeve teknike.

Qendra e Restaurimit dhe Konservimit, në kuadër të Departamentit të Koleksioneve të Veçanta, në skemën organizative të BKUK-së ka ekzistuar prej vitit 1981, porse nuk ka funksionuar asnjëherë deri më tash.

Edhe pse që nga atëherë Qendra e Restaurimit dhe Konservimit është pajisur me një seri aparat-urash dhe mjetesh për restaurim dhe konservim, ato nuk janë vënë në përdorim asnjëherë. Mosfunksionimi i Qendrës ka qenë pasojë e mungesës së arsimimit profesional të kuadrove, të afta të restaurojnë materiale bibliotekare me rëndësi të veçantë.

PËRGATITJET PROFESIONALE DHE TEKNIKE

Stafi që tashmë ka marrë përgjegjësinë që të nisë punën për restaurimin e materialeve, të cilat në fondin e BKUK-së janë të veçanta dhe me prioritet për t'u 'shëruar' dhe konservuar, ka kaluar nëpër disa faza, si: të informimit

me gjendjen faktike në këtë Qendër, të iniciativave dhe përgatitjeve konkrete për të filluar punën, të përcjelljes së trajnimeve nga kjo fushë dhe të përgatitjes teorike - literaturës, në lëmi të restaurimit dhe të konservimit.

Së pari është bërë identifikimi (testimi) i gjendjes së pajisjeve dhe funksioni i tyre; janë nxjerrë njohuri nga katalogët e pajisjeve dhe mjeteve të tjera teknike, si dhe është prezantuar e gjithë gjendja reale e kësaj Qendre.

Gjatë procesit të këtyre përgatitjeve, stafi është hyrë nëpër disa faza të trajnimit.

Në Arkivin Shtetëror të Kosovës (një muaj) është trajtuar - restauruar dhe konservuar material arkivorë. Gjatë kësaj kohe janë fituar shkathtësi në pastrimin dhe neutralizimin e materialit bibliotekar, restaurimin me dorë, laminimin etj.

Në Bibliotekën Kombëtare të Tiranës - Departamenti i Mirëmbajtjes së Librit (dy javë) janë kryer punë praktike, si: laminimi me dorë, qepja e librit, restaurimi i librit me lëkurë, restaurimi i qosheve, kapakëve (kopertinave) dhe shpinës së librit.

Në vizitën në Laboratorin për Restaurim dhe Konservim në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Shkupit, janë marrë informata për identifikimin e llojit të mikroorganizmave (dëmtuesit të materialit bibliotekar), dezinfektimin e materialit bibliotekar - sipas llojit të mikroorganizmave,

përdorimin e pH metrit për caktimin e aciditetit të materialit bibliotekar, neutralizimin, përdorimin e metilcelulozës (lloj ngjytësi lehtë i manipulueshëm, që nuk është përdorur ende nga ne) etj.

Janë përcjellë ligjërata dhe konsultime, gjatë Javës së Bibliotekës, nga Sophia Jordan, udhëheqëse në Universitetin Johns Hopkins në Departamentin e Restaurimit në Milton S. Eisenhower Library - USA. Në këtë kontekst, janë përdorur edhe referenca nga literatura profesionale në fushë të restaurimit dhe të konservimit, të cilat kanë ndihmuar në raste të caktuara, gjatë trajtimeve që tashmë ka filluar t'u bëhet materialeve për restaurim.

Në përfundim, si dhe gjatë fazave të trajnimit, Qendra e Restaurimit dhe Konservimit ka identifikuar nevojat për të nisur punët dhe është pajisur me materiale elementare shpenzuese - të nevojshme për restaurim, duke adaptuar edhe kushte të tjera teknike në hapësirën e dedikuar për këtë Qendër.

FUNKSIONIMI I QENDRËS SË RESTAURIMIT

Duke kaluar nëpër një proces të tillë përgatitjeje dhe aftësimi, (mbështetur në metoda klasike dhe kushtet dhe rrethanat që janë diktuar) Qendra e Restaurimit dhe Konservimit, tashmë ka vijuar të aktivizojë tërë potencialin e vet profesional. Gjatë fazave të restaurimit është duke u bërë procesi i pastrimit dhe deacidimit ujon të materialit për restaurim, riparimi klasik dhe përforsimi me letër restauruese, lamini, qepja e librit. Së shpejti, kur do të sigurohet edhe materiali tjetër adekuat, do të mund të kryhet edhe restaurimi i librit me lëkurë, si dhe restaurimi i hartave.

PERSPEKTIVAT

Stafi tashmë ka synime të qarta se çfarë duhet bërë tutje, në mënyrë që të përballet me sfidat që do të diktojnë metodat bashkëkohore të restaurimit dhe konservimit të materialit bibliotekar. Do të duhej përkrahje e madhe nga të gjitha institucionet tona, duke pasur parasysh vlerën tejet të rëndësishme që ka ruajtja e materialeve me vlerë kombëtare e të cilat janë të rrezikuara të shkatërrohen. Vullneti dhe përgjegjësia për të përparuar



këtë proces, e ka shtyrë stafin të punojë në projektin për modernizimin e Qendrës së Restaurimit të BKUK-së.

Realizimi i plotë i projekteve është i kushtëzuar nga përgatitja e stafit - i aftë për t'u përballur me proceset bashkëkohore në fushë të restaurimit. Në këtë kontekst, do të duhej të realizohen trajnime afatgjate për metodat bashkëkohore të restaurimit dhe konservimit që kanë të bëjnë me identifikimin e materialeve që do të duhej restauruar, të shkaktarëve që e kanë dëmtuar atë, format e trajtimit, mënyrën e për-

dorimit të mjeteve teknike, mirëmbajtjen e tyre etj. Qendra e Restaurimit do të duhej të pajisej me mjete teknike bashkëkohore dhe material tjetër shpenzues - sipas standardeve ndërkombëtare restauruese, si: me pajisje për restaurim dhe ruajtje të materialit bibliotekar në përputhje me kushtet që kërkohen për materialin bibliotekar të restauruar dhe atë të deponuar, mjete për identifikimin e mikroorganizmave, për ndriçimin e shkrimeve të dobëta, pajisje për thithjen e pluhurit, për deacidi-

fikim, për mikrofilmim etj. Gjithë materiali i restauruar dhe ai deponuar do të duhej të qëndronte në kushte teknike dhe klimatike, në përputhje me normat dhe standardet bashkëkohore, duke matur lagështinë relative, temperaturën, dritën etj.

Çfarë mund të bëhet është bërë. Hapi i parë është hedhur. Qendra e Restaurimit dhe Konservimit ka nisur punën dhe, mbështur në përkrahjen që do ta ketë, do të mbikëqyrë gjithë procesin e ruajtjes dhe të restaurimit të fondit bibliotekar në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës.

LONDËR - ANGLI

Përfaqësues të BKUK-së zhvilluan një takim pune në Londër, gjatë të cilit u takuan me udhëheqësit kryesorë të Bibliotekës Speciale të Kolegjit Mbretëror të Londrës. Gjatë këtij takimi, në mënyrë të hollësishme u demonstroi puna dhe funksioni i programit të automatizuar bibliotekar ALEPH 500. Menaxherët e këtij sistemi, Pete Sudell dhe Margaret Richardson, demonstroi procesin e punës dhe aplikacionet e mundshme që ofron ALEPH 500. Palët nga Londra dhe Prishtina shkëmbyen idetë e dyanshme për procesin e mëtutjeshëm të zbatimit të sistemit ALEPH 500 në BKUK, duke iu përshtatur kërkesave dhe rrethanave të institucionit. Është potencuar se ky sistem do t'u ofrojë përdoruesve të BKUK-së shërbime efikase, në sektorët e pasurimit, katalogimit, qarkullimit, serialeve, siç janë: procesi i porosisë së librit, (parakatalogimi), regjistrimi i faturave të blerjes, aranzhimi i buxhetit vjetor, baza e të dhënave të furnizuesve të bibliotekës etj. Programi do të ofrojë edhe shërbime të tjera të Katalogimit dhe të Qarkullimit, të cilat dukshëm do ta përmirësojnë procesin e punës në BKUK.



MASSACHUSETTS-SHBA



Zyra për Çështje të Arsimit dhe të Kulturës në Departamentin e Shtetit Amerikan do të financojë Projektin për Zhvillim të Personelit Bibliotekar në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës. Lidhur me këtë çështje, Instituti për Trajnim dhe Zhvillim (ITD) dhe Kolegji Simmons i Studimeve Postdiplomike për Bibliotekari dhe Shkenca Informativ (GSLIS) në Massachusetts-SHBA, do të angazhohen për realizimin e këtij projekti, me ç'rast nëntë kandidatë nga Kosova do t'u nënshtrohen politikave dhe procedurave të bibliotekarisë së shekullit XXI, ndërsa më pas do të shërbejnë si bibliotekarë të specializuar në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës. Ky projekt do të përkrahë plan-programet ekzistuese universitare dhe do të kërkojë zhvillimin e koleksioneve, përvojë me materiale të ndryshme elektronike dhe disa materiale të shtypura referuese, si dhe do t'i mbështesë shërbimet për përdoruesit e bibliotekës.

QUEENSLAND-AUSTRALI

Dr. Amos Owen Thomas, koordinator i Programeve Donatore nga Departamenti i Marketingut dhe i Administratës, nga Universiteti Griffith në Queensland të Australisë, i dhuroi Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare një fond librash të fushës së marketingut dhe administratës. Ky donacion është realizuar në kuadër të Projektit "World Donation Programme", projekt ky i shtrirë në nivel botëror për bibliotekat e vendeve në transicion. Shpenzimet eventuale të bartjes janë mbuluar nga Universiteti Griffith i Queensland-it. Ndër titujt me rëndësi të këtij donacioni janë: "Essentials of Services Marketing" nga Douglas Hoffman, "International Business" nga Robert Grosse, "Marketing" nga Peter Reed, "International Marketing" nga Lloyd Russow dhe tituj të tjerë të rëndësishëm.



Jean Arthur Creff



BRUKSEL - NATO

Drejtori i Bibliotekës së NATO-s nga Brukseli, z. Jean Arthur Creff, u takua me drejtorin e BKUK, dr. Sali Bashota. Ky takim synonte thellimin e bashkëpunimit në fusha me interes të ndërsjellë bibliotekar ndërmjet dy bibliotekave, gjatë të cilit u shpreh vullneti i përbashkët për të bashkëpunuar në të ardhmen në plane konkrete, posaçërisht, në fushën e bibliotekarisë. Bashkëbiseduesit diskutuan edhe për mundësitë e pasurimit të fondeve të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës me botime të NATO-s, botime këto që do sigurohen nga Brukseli. BKUK-ja do të kontribuojë për pasurimin e Bibliotekës së NATO-s nga fondi i botimeve kosovare me interes të veçantë.

Agjencia Ndërkombëtare e ISBN-së ka filluar përgatitjen për publikimin botëror të PIID-së (Publisher International ISBN Directory). Në këtë publikim do të jetë e përfshirë edhe Agjencia Kombëtare e ISBN-së në BKUK, e cila i dërgoi të dhënat përfundimtare të botuesve kosovarë për vitin 2004. Agjencia e ISBN-së në Kosovë ka bërë të ditur se në katalogun botëror të botuesve, në vitin 2004 Kosova prezantohet me 210 botues, prej të cilëve, 15 botues i takojnë grupit të parë, me botime më të mëdha, 60 të tjerë grupit të dytë, me numër mesatar të publikimeve, ndërsa grupit të tretë dhe të fundit, i takojnë 133 botues, shumica prej të cilëve janë privatë. Gjithashtu, ditë më parë u prezantua edhe botimi më ri i Manualit Përdorues të ISBN-së, i përgatitur nga Agjencia Ndërkombëtare e ISBN-së. Në këtë botim janë të përfshira të gjitha ndryshimet, që do të pasojnë nga viti 2007. Manuali pritet të përkthehet dhe të botohet edhe në gjuhën shqipe nga Agjencia Kombëtare e ISBN-së për Kosovë.

BERLIN - GJERMANI

KAJRO - EGJIPT

Një kontingjent librash ka arritur edhe nga Kajroja, i mbledhur nga intelektualit dhe aktivisti shqiptar në Kajro, Beqir Ismaili. Ai ka dhuruar botimet e veta të publikuara në botën arabe, të cilat janë të shkruara në gjuhën arabe, ndërsa tematika e tyre i përket ngjarjeve në Kosovë, sidomos, atyre të vitit 1999. Rëndësia e këtyre librave qëndron në faktin se botimi i tyre në gjuhën arabe, pikërisht, në kohën kur Kosova gjendej në luftë, ka ndikuar që të sensibilizohet bota arabe për çështjen e Kosovës, duke zgjuar kureshtjen e shumë intelektualëve arabë.

HERFORDSHIRE - ANGLI



Melonie Aemston

Në Kompaninë Ex-Libris, përfaqësia në Herfordshire të Londrës, u realizua procesi i dytë i zbatimit të sistemit ALEPH 500. Me këtë rast u bë analizimi i sistemit, fazë kjo kur paraqiten konceptet themelore të funksionimit dhe strukturës së të dhënave të ALEPH-it. Kompania shitëse mësoi nga stafi i BKUK-së për strukturën dhe shtrirjen aktuale të procesit të punës dhe mori vendime për konfigurimin bazik të instalimit. Pra, takimi u përqendrua në këto objektiva: sigurimi në pikëpamje të përgjithshme për ndërtimin e Sistemit ALEPH, konfigurimi bazik i instalimit dhe plotësimi i pyetësorëve të konfiguracionit.

BIBLIOGRAFIA E REVISTËS KOHA 1978-1989

Është Bibliografi e organizuar dhe sistemuar profesionalisht për të gjitha materialet e saj të botuara brenda 11 viteve - sa kohë ka dalë kjo revistë. Për rëndësinë e bibliografisë dëshmon shumë puna e palodhshme e autorit që ka sistemuar 2359 njësi bibliografike dhe mënyra se si janë sistemuar gjatë librit, duke ua lehtësuar shumë punën studiuesve të ndryshëm, për të cilët ka material kjo revistë. Bibliografia e sistemuar ndahet në shtatë pjesë: I. Letërsia shqipe, II. Letërsia e popujve të Jugosllavisë, III. Letërsia botërore, IV. Letërsia gojore, V. Artet pamore, VI. Filozofia, Sociologjia, Kulturologjia dhe VII. Treguesit, duke pasur edhe një nënndarje të secilës prej tyre në poezi, prozë, dramë, etj. Kjo ndarje paraqet sistemimin e asaj literature të revistës, e cila përmbante materiale artistike, shkencore, kulturore, etj. Por, njëkohësisht, paraqet edhe një ndarje në gjini dhe përkatësi vendore varësisht prej vendit, të cilit i përket ajo literaturë. Ndërsa, brenda këtyre sistemimeve grupe dhe nëngrupeve, si kriter tjetër i renditjes së këtyre njësisve bibliografike, është marrë emri i autorit. E gjithë kjo punë e palodhshme e autorit ua lehtëson për mrekulli lexuesve dhe studiuesve punën në përdorimin e kësaj reviste, duke ia bërë të mundshme depërtimin sa më të lehtë dhe të shpejtë në informacionet e fushave të ndryshme, varësisht prej interesimeve që ka lexuesi. Kjo Bibliografi shërben për orientime të formave të ndryshme, duke ua hapur të gjitha dyert studiuesve të profesioneve të ndryshme.



BIBLIOGRAFIA E REVISTËS KOSOVA 1972 – 2003



Është bibliografia e dytë e botuar kohëve të fundit nga BKUK-ja e autorit Gjon Berisha, duke pasuruar rrafshin bibliografik me një bibliografi të natyrës tjetër dhe duke e vazhduar traditën e rrafshit bibliografik. Që në titull shenjohej koha (1972 – 2003) brenda të cilës bëhet bibliografia e atyre shkrimeve të kësaj reviste, pra një periudhë 31-vjeçare ku numërohen 25 numra të kësaj reviste. Revista Kosova e botuar në fillim nga Enti i Historisë së Kosovës dhe më vonë nga Instituti i Historisë së Kosovës është e një rëndësie të veçantë, të cilën gjë e citon edhe autori në parathënie: “Revista shkencore “Kosova” ka qenë dhe është një vatrë, në të cilën është prezantuar historiografia e Kosovës dhe e shqiptarëve në përgjithësi”. Libri ndahet në dy pjesë kryesore; në bibliografi alfabetike dhe në bibliografi kronologjike që bëhen bërthama e sistemimit të materialit në këtë libër për materialin e botuar në revistën Kosova. Ky sistemim është udhërrëfyes për lexuesit se ku mund ta gjejnë materialin e caktuar, për të cilin është i interesuar ai. Në pjesën e parë ku gjendet Bibliografia alfabetike “njësitë bibliografike janë renditur sipas radhitjes alfabetike globale duke u bazuar në autorë, kurse brenda autorit janë radhitur të gjitha njësitë bibliografike sipas alfabetit pa marrë parasysh renditjen kronologjike të tyre”. Ndërsa në pjesën e dytë ku si parim drejtues kemi renditjen kronologjike të botimeve sipas kohës se kur janë botuar, prapë kemi një renditje me bazë

alfabetike, por prapë sistemi kronologjik është kryesori dhe renditja alfabetike është nënrenditje. Përfundimisht është një bibliografi që në një formë shteruese paraqet të gjithë materialet e botuara në revistën Kosova.

SFIDAT E ZHVILLIMIT TË BIBLIOTEKAVE PUBLIKE NË KOSOVË

Ky libër i autorit Bedri Gashi i botuar nga BKUK-ja është ndër librat që me përkushtim dhe në mënyrë profesionale i qaset problemeve me të cilat ballafaqohen sot bibliotekat publike në Kosovë. Përveç kësaj, libri shquhet edhe me projektet që mendohet të sjellin kalimin e kësaj gjendjeje në të cilën gjenden Bibliotekat publike në Kosovë. Pra tematikisht kemi ndarjen e librit në dy pjesë (edhe pse kjo nuk shënohet në libër); a) në një pjesë ku paraqiten problemet e Bibliotekave publike, që në fakt mbështetet më shumë në përvojën praktike dhe studimet e asaj praktike që autori ka pasur - në komunikim me bibliotekat publike dhe b) në pjesën tjetër ku pretendohet të kalohet nga ato probleme përmes trajnimeve, librave profesional, raporteve të IFLA-FAIFE-s, etj. Kurse strukturalisht vepra ndahet në gjashtë pjesë, ku në formë kronologjike jepen të dhënat prej problemeve drejt tejkalimit të tyre. Ecja në kohë e bibliotekarisë në Kosovë sikur ia jep vlerën këtij libri që mundohet sa më shumë të jetë konkret dhe referencë të përhershme ta ketë gjendjen në të cilën gjenden bibliotekat publike në Kosovë. Varfëria e madhe institucionale dhe profesionale që i përçolli bibliotekat publike prej pas luftës po vjen duke u zvogëluar dita-ditës dhe libri është një hap tutje në këtë drejtim. Ai paraqet kërkesat emergjente, të cilat duhet të plotësohen për zhvillimin e bibliotekave publike drejt profesionalizimit dhe ngritjes teknologjike të tyre. Pavarësimi i bibliotekave publike, krijimi i hapësirave të reja dhe të mjaftueshme për lexuesit, pasurimi i fondeve, rregullimi institucional, trajnimet profesionale janë vetëm ca kërkesa të natyrave të ndryshme që çojnë drejt zhvillimeve të ndryshme e veçanërisht të pjesës më të ndjeshme të bibliotekave publike që i shtron autori në libër. Përfundimisht është njëra ndër përpjekjet serioze dhe profesionale që pretendon ngritjen e përgjithshme të bibliotekave publike në Kosovë.

